



**Raporti i Zhvillimit të
Aktiviteteve Afariste në
K.R.U."Gjakova" Sh. A. Gjakovë
Gjatë Vitit 2017**

1. TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje	4
Fjala hyrëse e Kryeshëfit Ekzekutiv	5
RAPORTI I KRYESUESIT TE BD	7
Aktivitet dhe përformanca e Ndërmarrjes	8
Pasqyr e Performances Operat.Financiare	11
RAPORTI I KRYESHEFIT EKZEKUTIV.....	17
Ngjarjet kryesore të vitit	20
Pasqyra e Përformances Operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të përformances -	24
Pasqyra e Performances financiare dhe rezultatet	30
Progresi me planin e biznesit	33
Shpenzimet kapitale dhe projekteve	37
Perspektiva për vitin e ardhshëm	40
Rreziqe e të ardhmes së Korporatës	45
RAPORTET E AUDITORIT TË BRENDSHËM	48
Raportimet sipas ligjit Mbi Ndërmarrjet Publike.....	51

KRU "Gjakova" Sh.A.

Fakte dhe shifra

KRU "Radoniq" Sh.A. Gjakovë ka kapacitet dhe mund të furnizon me ujë të pijshëm rreth 230.000 banor, me kapacitet 500 lit/sec, apo prodhim të ujit të pijes në sasi prej 43.200 m³ në ditë. Në vitin 2018, pritet të përfundojë ekzekutimi i fazës së II të Fabrikës për Përpunimin e ujit, që nënkupton prodhimin e ujit edhe për 500 lit/sec, që do kemi kapacitet të furnizimit me gjithësejtë 1000 lit/sec

Nekemi:

- Kaptazhë në lumin Bistricatë-Deçanit,
- Kanalin derivues prej 9 km
- Liqenine Radoniqi si i vetmiburim dhe burimet e fshatrave Damjan 1 & 3, Gërquinë, Opterushë, Hoqë e Madhe, Senoc, Drenoc, që shërbejnë për furnizim për këto fshatra.
- Kapaciteti (Maksimal) i Liqenit është **117 milion m³** kur është i mbushur plotë, në kotën mbidetare prej **456 m**,
- Gjatësia maksimale e Liqenit është **5.035 m'**
- Gjerësia maksimale e Liqenit është **2.100 m'**
- Thellësia maksimale është **61 m'**
- Sipërfaqja e Liqenit me ujë në kuotën maksimale është **644 hektar**
- Stacione filtrave për trajtimin e ujit
- 30 rezervualet e ujit
- 35 stacione pompimi
- **741.278 km**, rrjet kryesor të ujës jellësit

Përveç furnizimit me ujë të pijshëm KRU "Radoniq" bënë shërbime për Largimin e ujërave të përdorura me:

Gjakovë 56 km rrjet kanalizim fekal, Rahovec 25 km rrjet kanalizim fekal dhe 1250 pusetat e kanalizimit fekal



Regjioni i furnizimit me shërbime

Synimet tona

KRU "Radoniq" Sh.A. ka për synim furnizim të qëndrueshëm me ujë të pijshëm dhe cilësor, shërbime të efektshme me përkujdesje mjedisore si dhe të kërkojë më donacione për projekte trimëkëmbëse:

T'u ofrojmë konsumatorëve shërbime të mira dhe t'i bindim ata për pagesën e faturave

Ta ruajmë dhe përmirësojmë mjedisin gjithandej ku veprojmë,

T'u mundësojmë punëtorëve tanë zhvillim personal dhe karrierë të kënaqshme,

T'i bindim donatorët që investimet e tyre do të jenë të shpagueshme,

Zgjerimi i rrjetit në Regjione tjera.

Hyrje:

Raporti vjetor është obligim i kompanisë që del nga Ligji Nr. 03/L-087 për ndërmarrje publike .Në këtë raport vjetor që përfshin një periudhë prej 12 muajsh të aktivitetit të vet, ne do të sjellim përmbledhje duke filluar nga fjala hyrëse e Kryeshefit Ekzekutiv i cili bartë në vete performancën e kompanisë bashkë me aktivitete e kompanisë dhe politikat ndikuese në zhvillimin e biznesit të saj.

Raporti më pas vijon nga - Raporti i Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve si dhe KE-së, duke ofruar me këtë rast të dhëna për ngjarjet kryesore për periudhën raportuese, të dhënat për performancën operative dhe financiare dhe progresin në drejtim të realizimit të Planit të Biznesit.

Kur jemi te progresi drejt realizimit të planit të biznesit raporti i ynë ofron të dhëna të detajuara për shpenzimet, investimet kapitale të kompanisë dhe gjithashtu një elaborim të çështjes së planifikimit bashkë me rreziqet e mundshme ndikuese .

Po ashtu brenda raportit është paraqitur edhe skena organizative e stafit të kompanisë, ndryshimet e ndodhura gjatë kësaj periudhe si dhe një pjesë i është kushtuar çështjeve të ndryshme të lidhura me kontestet gjyqësore.

Për të qenë raport sa më i qartë dhe i kompletuar, brenda tij janë paraqitur edhe grafikone, tabela statistikore e skena tjera me sqarime të nevojshme .Raporti Vjetor 2017 ka të bashkangjitur edhe shtojcën apo Aneksin i cili përmban të dhëna tjera shtesë të cilat mbasin për përdorim të aksionarit.

Në përpjekje të realizimit të këtij raporti, për të pasqyruar aktivitetet e kompanisë, suksesin e saj në realizimin operativ dhe financiar ,gjithsesi që jemi të bazuar edhe në udhëzuesin në lidhje me hartimin e raportit vjetor, po ashtu edhe në ligjin për NP.

Ky raport është i rëndësishëm në kuptimin e përmbushjes së objektivave dhe zhvillimeve të rëndësishme që kanë ndodhur në kompani qoftë në aspektin financiar po ashtu edhe në aspektin teknik-operativ, duke u fokusuar në përmbushjen e caqeve të përcaktuara në planin e biznesit për vitin 2017.

Raporti vjetor që po paraqesim për vitin 2017 , synon jo vetëm të prezantoj aktivitetet e tyre gjatë gjithë kohës, por do të shërbej si publikim i arritjeve të realizuara dhe identifikues i fushave që kanë nevojë për përmirësim .

Raporti përmban të gjitha shënimet e Kompanisë për çdo Departament dhe atë e ilustron me të dhëna të shumta, të cilat prezantojnë situatën aktuale në të cilën ndodhet Kompania .

FJALA HYRESE E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

Viti 2017 për KRU "Gjakova" Sh.A. Gjakovë, shënon një vit të suksesshëm të ushtrimit të aktivitetit të saj afarist. Arritjet e KRU-se janë si rezultat i angazhimit të mirëfilltë të të gjithë punëtorëve dhe ekipit menaxherial, që u kurorëzuan me sukses të mbështetjes institucionale nga aksionari dhe palët e interesit, si dhe një qeverisjeje profesionale korporative nga ana e Bordit të Drejtorëve.



Z. Ismet Ahmeti – Kryeshef Ekzekutiv

Ofrimi i shërbimeve kualitative dhe të besueshme për konsumatorët është një ndër detyrat kryesore të kompanisë. Në këtë drejtim angazhimi profesional nga ana e punëtorëve në një anë, dhe investimet në rritjen e kapaciteteve të prodhimit të ujit të pijes dhe shërbimeve të tjera dhe arkëtimit të hyrave vetanake në anën tjetër, ka ndikuar në rritjen e besueshmërisë së KRU-së ndaj Konsumatorëve të vet, Institucioneve Lokale dhe Qendrore, të cilat janë në pajtueshmëri të plotë me Misionin dhe Vizionin e Kompanisë .

Menaxhmenti i Kompanisë gjatë vitit 2017, si dhe tërë stafi i Kompanisë janë munduar me perkushtimin e tyre maksimal të arrijnë caqet e dëshiruara të biznesit dhe për konsumatorin të kenë shërbimet më të mira ,duke u munduar të arrijnë përmes ; Bashkëpunimit me Konsumatorin, informimi i vazhdueshëm i tyre për shërbimet, shqyrtimi me kohë dhe në mënyrë efektive të kërkesave të tyre, intensifikimin i aktivitetit për zvogëlimin e humbjeve të ujit , rritjen e faturimit dhe arkëtimit, si dhe organizimit të punës dhe motivimit të mirë të stafit.

Gjatë vitit 2017 , Raporti i Auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare për vitin 2017 reflekton për punën profesionale dhe perkushtimin e kompanisë për zbatimin e standardeve më të larta në proceset e punës dhe përmbylljen me shumë sukses të shfrytëzimit të të gjitha resurseve të KRU-se. Një ndër detyrat kryesore të Kompanisë KRU "Gjakova" Sh.A. është ofrimi i shërbimeve kualitative dhe të besueshme për konsumatorët . Rrjeti i ujësjellësit është mirëmbajtur sipas planit të paraparë, janë realizuar kontrolla të rregullta si dhe inspektime të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit .Implementimi i suksesshëm i projekteve ka ndikuar në përmbylljen e objektivave themelore të Kompanisë.

Për punën profesionale dhe perkushtimin e kompanisë për zbatimin e standardeve më të larta në proceset e punës dhe përmbylljen me shumë sukses ,KRU "Gjakova"sikurse në vitin paraprak edhe vitin 2017 e ka përmbyll me sukses maksimal , nga Raporti i ZRRUK-u është vlerësuar se Kompania ka arritur me sukses shume tregues të performances .

Në kuadër të kësaj vlen të përmendet edhe realizimi me sukses i Projekteve të financuara të financuara nga Qeveria e Kosovës ; Linja e ujit të pijes nga baseni i Radoniqit, linja e Anadrinit , linjat dhe infrastruktura mbështetëse, Faza e dytë. Totali i donacionit për vitin 2017 përfshinë shumën prej 1, 400,000.00 € e cila shumë do të rrezultoi në rritjen e kapaciteteve prodhuese të ujit në 500 lit në sec gjë që do të mundësonet furnizim 24 orë pandërprer gjatë tërë vitit si dhe do të zgjerohet furnizimi në masë të madhe i rrjetit të ujësjellësit në fshatrat e regjionit me të cilën është i shtrirë KRU"Gjakova". Ky është një projekt i vjetër i hartuar që nga themelimi i Hidrosistemit dhe i pa realizuar deri më sot , për arsye financiare. Projekti në fjalë do të ndikoi në avancimin e Kompanisë në arritjen e treguesve të performancave operative

dhe financiare; në rritjen e numrit të konsumatorëve ,rritjen e faturimit si dhe inkasimit për konsumatorët e ketyre Fshatrave .

Kanali derivues I basenit te Radoniqit, linja dhe infrastruktura mbështetëse. Ky Projekt është e arritur kolosale per KRU "Gjakova",bazuar në faktin e njohur qe 40 vite të ndërtimit të këtij sistemi kanali derivues si projekt i financuar nga Banka Botërore nuk është arrit të përmbyllet që uji i lumit përmes kanalit të betonuar të derdhet deri ne liqe .3000 metra gjatësi te kanalit kane qene të pa përfunduara ,gjë që kjo gjendje ka bërë që rrjedhja e ujit te bart me vete sasi te mëdha te dheut ne liqe si dhe të ketë humbje të mëdha të ujit ne Liqe . Me mjetet te cilat i ka nda si donacion Qeveria nga buxheti 2013,2014,2015 2016 dhe tani edhe në vitin 2017 do të arrihet që të realizohet një Projekt kolosal i cili do të përmbyllë ndërtimin e infrastruktures ujore të funksionimit të këtij sistemi ne mënyrë më kualitative dhe kuantitative . Punët e zhvilluara rreth realizimit të këtij Projekti kanë shkuar në çdo vit me një realizim prefekt si ; realizimin me kohën e planifikuar ,kualitetin e kërkuar të ndërtimit ashtu edhe me kuantitetin e ndërtimit .Të arriturat respektivisht progresi që Kompania ka bërë gjatë vitit 2017 janë paraqitur më detalisht në piken 3.4 të këtij Raporti i cili shqyrton implementimin e Planit të Biznesit për vitin 2017.

Zhvillimi i Kompanisë dukshëm është vërejtur në infrastrukturën ligjore dhe rregullore.

Janë aprovuar Rregulloret e brendshme të Kompanisë në harmoni me Ligjet në fuqi në Kosovë si dhe është bërë implementimi i Kontrates Kolektive si dhe është bërë harmonizimi i këtyre akteve me ndryshimet që kanë pasuar të ligjeve.Me ndryshimin e Ligjit tani i quajtur Ligji Mbi Rregullimin e Sherbimeve të Ujit ,kompania ka hartuar edhe rregullat e brendshme të Kompanisë të cilat priten të miratohen nga BD .

Punën profesionale dhe përkushtimin e Ekzekutivit në zbatimin e standardeve më të larta në proceset e punës dhe përmbylljen me sukses të shfrytëzimit te të gjitha resurseve ujore, më së miri e dëshmon opinionin i Auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare për vitin 2017 , ku janë kryer me kohë obligimet e klientëve dhe institucioneve të Shtetit të Kosovës .

Janë aprovuar shumë dokumente të rëndësishme, si dhe politika dhe procedura në harmoni me Ligjet, Urdhëresat Administrative si dhe akteve te tjera te brendshme te Kompanisë.

Duke e përmbyllur, kam kënaqësinë të përgëzoj Bordin Drejtorëve për bashkëpunimin e sinqertë për zhvillimin e politikave progresive për Kompaninë sipas Ligjit mbi NP, të gjithë menaxherët, zyrtarët dhe punonjësit e Kompanisë sonë për punën e zellshme që kanë bërë gjate vitit 2017.

Posaçërisht falënderoj Zyrën e Njësisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, për mbështetjen profesionale dhe materiale në procedurën e realizimit të donacioneve nga ky autoritet.

Falënderoj partnerët tanë afaristë, si dhe mirënjohje dhe respekt të veçantë për madhërinë e tij **Konsumatorin tonë besnik**, i cili na beson dhe i pëlqen produkti i jonë, uji i pijes me cilësi, sasi dhe shtypje të mjaftueshme, me furnizim 24 orësh, e që shpresojmë të kenë begatuar dhe lehtësuar shumë nevojat e përditshme dhe jetën e tyre në përgjithësi.

2. RAPORTI I KRYESUESIT TE BORDIT TE DREJTOREVE

2.1 AKTIVITETET DHE PERFORMANCA E NDERMARRJES

Aktivitet kryesorë të ndërmarrja nga KRU kanë qenë në përputhshmëri me Ligjin Mbi Ndërmarrjet Publike, Ligjin Mbi Shoqërinë Tregtare, me politikat e Qeverisë për NP, me qeverisjen korporative dhe me Kodin e Etikës, gjithnjë duke i zbatuar politikat e aksionarit e me qëllim të ruajtjes së vlerës së aseteve.

Aktivitet kryesorë kanë pas të bëjë me krijimin e kushteve që kompania ti realizoi synimet e parapara sipas Planit të Biznesit. Çështjet e dinamikës së operative kanë qenë aktivitetet e dorës së parë, krahas aktiviteteve për çështjet financiare, të prokurimit si dhe të racionalizimit të shpenzimeve në të gjithë sektorët e



Z. Fatos Koshi - Kryesues i BD 1

punës në KRU, me përkushtim të posaçëm për shfrytëzimin e grandeve ,që kanë ndikuar dhe ndikojnë në ngritjen e performancës teknike të infrastrukturës për qasje më të mirë, për aktivitet të suksesshëm të operative së ujësjellës kanalizimeve .

Çështja e shfrytëzimit të mjeteve të grandeve të dhëna nga Qeveria e Republikës së Kosovës përmes MZHE, MMPH,CDI-së KËF-Bankes etj. kanë qenë aktivitete me obligime të nivelit më të lartë, me qëllim që mjetet e dhëna të shfrytëzohen për avancimin e aktiviteteve të kompanisë, e në favor të krijimit të kushteve sa më të mira për konsumator.

Gjatë periudhës Janar–Dhjetor të vitit 2017, Kompania ka zhvillua aktivitete të ndryshme të qeverisjes së korporatave, bazuar në Ligjin nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike. Aktivitet kryesorë në këtë aspekt përfshijnë aktivitetet e BD, dhe Komisionit të Auditimit.

Çdo mbledhje e rregullt e Bordit ka trajtuar disa pika që paraqiten si pika të zakonshme dhe përfshijnë vërtetimin e kuorumit dhe aprovimin e pikave të rendit të ditës, si Proceserbalin nga mbledhja paraprake e BtD , shqyrtimin e raportit të mbledhjes së Komisionit të Auditimit dhe Komisioneve tjera dhe informatën rreth aktiviteteve nga Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv.

Raportet nga mbledhjet e Komisionit të Auditimit, janë prezantua si materiale në mbledhjet e rregullta të Bordit dhe janë dërguar në NJPMNP. Bordi i Drejtorëve i KRU-së duke mos dal nga suazat e kompetencave të saja si autoritet i emëruar për përfaqësimin e aksionarit, e plotësisht në harmoni me Ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës dhe në harmoni me interesat e aksionarit ka marr Vendime dhe Qëndrime me të cilën kanë të bëjnë me afarizmin e Kompanisë .

Aktiviteti i Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit

Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2017 i ka mbajtur 12 Takime të rregullta me përbërje të plotë dhe 1 mbledhje të Aksionarit . Në kuadër të Bordit të drejtorëve ka vazhduar të funksionojë edhe autoriteti i zgjedhur nga Qeveria -Komisioni i Auditimit i cili gjithashtu i ka mbajtur gjithsejtë (12 takime).

Bordi i Drejtorëve ishte në kontakte të vazhdueshme me Menaxhmentin e Kompanisë. Në vazhdimësi ka kërkuar dhe është njoftuar, në kontakte direkt por edhe në formë të shkruar, për gjendjen dhe zhvillimet në kompani. Është mbikëqyrë menaxhimi i kompanisë dhe janë dhënë

këshillat e nevojshme për Kryeshefin Ekzekutiv. Në takimet e rregullta janë mbikëqyrë të gjitha ecuritë e biznesit, mbarëvajtja e tyre sipas vendimeve të Bordit si dhe aspekti ligjorë i vendimeve të Menaxhmentit të kompanisë. Lidhur me këtë Bordi i Drejtorëve është i informuar për të gjitha vendimet dhe zhvillimet e rëndësishme. Bordi i Drejtorëve i Kompanisë Rajonale "Gjakova" Sh.A, në përputhje me nenin 29 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087 ka shqyrtuar qështjet afariste të Kompani dhe ka aprovuar ;

Nga bledhja e 15 mbajtur me date 30.01.2017,u murr ;

VENDIM - Aprovohet unanimitisht Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv për muajin Dhjetor 2016 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU"Radoniq"sh.a-Gjakovë.

VENDIM- Aprovohet Unanimitisht Rregullorja 01/2016 për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve.

VENDIM- Aprovohet unanimitisht raporti i regjistrimeve të fundvitit si Depo,Arka,Inkasantët dhe Inventari 2016.

Nga bledhja e 16 mbajtur me date 27.02.2017 u murr ;

VENDIM- Aprovohet Unanimitisht Raporti i IV-të tremujor Tetor-Dhjetor 2016 mbi zhvillimin e Aktiviteteve Afariste në KRU Radoniq SH.A.Gjakovë.

VENDIM- Aprovohet Unanimitisht Raporti Vjetor 2016 mbi zhvillimin e Aktiviteteve Afariste në KRU Radoniq SH.A.Gjakovë.

VENDIM- Shfuqizohet pjesërisht vendimi me nr.protokoli 128 sa i përket pjesës së dhurimit të veturave si donacion për KRM "Çabrati".

VENDIM- Aprovohet kërkesa e Spitalit Regjional "Isa Grezda" për dhurim si donacion të një veture e tipit Golf 3.

Nga bledhja e nr 17 mbajtur me date 29.03.2017 u murr ;

VENDIM- Aprovohet unanimitisht Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv për muajin Shkurt 2017 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU"Radoniq"sh.a-Gjakovë.

VENDIM- Aprovohet Unanimitisht Raporti i Hulumtimit të Kënaqësisë së Konsumatorëve për vitin 2016 ndaj shërbimeve të KRU "Radoniq" Sh.A.Gjakovë.

VENDIM- Aprovohet Unanimitisht Raporti Final i Auditorëve të Pavarur dhe Letrës së Menaxhmentit për vitin 2016 në KRU"Radoniq"Sh.A.Gjakovë.

Nga bledhja e nr 18 mbajtur me date 27.04.2017 u murr ;

VENDIM- Aprovohet unanimitisht Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv për muajin Mars 2017 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU"Radoniq"sh.a-Gjakovë.

VENDIM- Aprovohet unanimitisht Rregullorja Nr. 1/2017 për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve

VENDIM- Aprovohet unanimitisht Rregullorja Nr. 2/2017 për procedurat e lidhjes së konsumatorëve në shërbimet e ujit.

VENDIM- Aprovohet unanimitisht Rregullorja Nr. 3/2017 për procedurat e ndërprerjes së shërbimeve të ujit.

VENDIM- Aprovohet unanimitisht Rregullorja Nr. 4/2017 për procedurat e faturimit për shërbimet e ujit

VENDIM- Aprovohet unanimitisht Rregullorja Nr. 5/2017 për matjen e konsumit të ujit

VENDIM- Unanimitisht Aprovohet ndryshimi i nenit 1 i Statutit të KRU"Radoniq"Sh.A.-Gjakovë .Mbështetur në Ligjin Nr. 03/L-087, "Për Ndërmarrjet Publike"; të Ligjit Nr. 02/L-123, "Për Shoqëritë Tregtare"; themelohet : **Kompania Rajonale e Ujësjellësit " Gjakova " SH.A.** Shkurtimi i emërimit të shoqërisë është **K.R.U."Gjakova"SH.A.**

VENDIM- Aprovohet unanimitisht Raporti Final i Zyrës Kombëtare të Auditimit "Menaxhimi dhe Monitorimi i Investimeve Kapitale në Ndërmarrjet Publike" 2014-2016.

Nga bledhja e 19 mbajtur me date 30.05.2017 u murr ;

VENDIM- Aprovohet unanimitisht Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv për muajin Prill 2017 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU"Radoniqi"sh.a-Gjakovë.

VENDIM- Aprovohet unanimitisht Raporti i l-rë tremujor Janar-Mars 2017 mbi zhvillimin e Aktiviteteve Afariste në KRU'Radoniqi'sh.a-Gjakovë.

VENDIM- Aprovohet kërkesa e Kryeshefit Ekzekutiv për shpërblim të punëtorëve me nga 50 Euro për nder të festës së "Fitër Bajramit".

Nga bledhja e 20 mbajtur me date 29.06.2017 u murr ;

VENDIM- unanimitisht Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv për muajin Maj 2017 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU"Radoniqi"sh.a-Gjakovë

Nga bledhja e 21 mbajtur me date 27.07.2017 u murr ;

VENDIM- Bordi Drejtorëve pas shqyrtimit dhe diskutimit të Raportit të Kryeshefit Ekzekutiv për Muajin Qershor 2017 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste merr

VENDIM - Aprovohet unanimitisht Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv për muajin Qershor 2017 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU"Radoniqi"sh.a-Gjakovë.

Mbledhja 22 mbajtur me date 29.08.2017

VENDIM- Aprovohet unanimitisht Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv për muajin Korrik 2017 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU"Radoniqi"sh.a-Gjakovë.

VENDIM- Aprovohet unanimitisht Rpaorti trmeujor Prill –Qershor 2017 mbi zhvillimin e aktivitetevea farsite ne KRU'Radoniqi'SH.A-Gjakove.

Nga bledhja e nr 23 mabjtur me date 28.09.2017 u murr ;

VENDIM- Aprovohet unanimitisht Rregullorja per marrjen dhe dhënien me qera te Objekteve pronave , hapësirave ne KRU"Radoniqi"sh.a-Gjakove.

VENDIM- Aprovohet Rregullorja mbi llogaritjen e të ardhurave personale për kategoriine e punëtorëve Arketues në KRU"Radoniqi"sh.a.Gjakovë

VENDIM -Aprovohet unanimitisht Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv për muajin Gusht 2017 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU"Radoniqi"sh.a-Gjakovë

Nga bledhja e 24 ,mbajtur me date 30.10.2017 u murr ;

VENDIM- Aprovohet unanimitisht Plan Biznesi 2018-2020 KRU'Radoniqi'SH.A-Gjakove dhe i njëjti përcillet NJPMNP-MZHE.

VENDIM- Aprovohet unanimitisht Rrgullorja mbi procedurat e arketimit ne portoarka ne KRU'Radoniqi'sha,Gjakove.punetoreve Arketues ne KRU"Radoniqi"sh.a-Gjakove

VENDIM- Aprovohet unanimitisht Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv për muajin Shtator 2017 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU"Radoniqi"sh.a-Gjakovë

Nga bledhja e 25 mbajtur me date 30.11.2017 u murr ;

VENDIM- Aprovohet unanimitisht Raporti TM3 Korrik –Shtator 2017 mbi zhvillimit te aktiviteve afariste ne KRU'Radoniqi'SH.A-Gjakove dhe i njëjti përcillet NJPMNP-MZHE

VENDIM - Aprovohet unanimitisht Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv për muajin Tetor 2017 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU"Radoniqi"sh.a-Gjakovë

Nga bledhja e 26 mbajtur me date 27.12.2017 u murr ;

VENDIM- Bordi Drejtorove pas shqyrtimit te Qendrimit te Komisionit Auditimit lidhur me kerkesen e KE per shperblimin e punetoreve me rastin e festes se vitit te ri me pako ne vlere prej 20 Euro dhe shperblim ne te ardhura personale ne vlere prej 100 Euro.

VENDIM- Aprovohet unanimitisht kërkesa e KE me nr protokolli 262.

VENDIM- Aprovohet unanimitisht Plani i menaxhimit të Thatësisë në KRU'Radoniqi'sh.a.

VENDIM- Aprovohet unanimitisht Strategjia mbi menaxhimin e humbjeve te ujit 2018-2022 KRU'Radoniqi'sh.a-Gjakove.

VENDIM- Aprovohet unanimitisht plotësimet ne Rregulloren mbi Shpenzimet e Parasë KRU'Radoniqi'sh.a.

VENDIM- Aprovohet unanimitisht Rregullorja mbi vleresimin e rriskut per te gjitha vendet e punes ne Kompani

Aktiviteti e Komisionit të Auditimit

Ndërsa Komisioni Auditimit i Kompanisë Rajonale "Radoniqi"Sh.A ,komfor kompetencave të përcaktuara në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087 , përmes mbledhjeve të rregullta ka shqyrtuar qështjet e rëndësishme afariste të Kompani .

Në mbledhjen e 15 të mbajtur me date 26.01.2017 u murr ;

VENDIM - Aprovohet raporti final prokurimit me një pasus që duhet cekur sipas gjetjes së Auditorës së Brendshme obligohet menaxhmenti që në një të ardhme shumë të afërt të eliminohen këto gjetje që mos të na vijnë të përsëritura këto gjetje sikurse vitin e kaluar

VENDIM - Aprovohet Plani Strategjik për Zyren e Auditimit të Brendshëm 2017-2019 në KRU Radoniqi Sh.A.Gjakovë.Vendim Aprovohet Plani Vjetor 2017 për Zyrën e Auditimit të Brendshëm në KRU Radoniqi Sh.A.Gjakovë.

Në mbledhjen e 16 të mbajtur me date 23.02.2017 u murr ;

QËNDRIM - Draft Raporti Menaxhimi i Mjeteve Themelore dhe Stoqueve në KRU Radoniqi Sh.A.Gjakovë përcillet për komente nga Menaxhmentit

Në mbledhjen e 17 të mbajtur me date 27.03.2017 u murr ;

VENDIM - Aprovohet Raporti Final për Menaxhimin e Mjeteve Themelore dhe Stoqueve në KRU Radoniqi SH.A. Gjakovë.

QËNDRIM- Draft Raporti Auditimi i Pasqyrave Financiare në KRU "Radoniqi"SH.A.Gjakovë – të përcillet për komente tek menaxhmenti.

QËNDRIM - Draft Raporti i Auditorëve të Pavarur dhe Draft Letra e Menaxhmentit për Vitin 2016 në KRU'Radoniqi'SH.A-Gjakovë – pas pranimit të Raportit Final përcillet që të prezentohet dhe aprovohet në Mbledhjen e Bordit të Drejtorëve

Në mbledhjen e 18 mbajtur me date 25.04.2017 u murr;

QËNDRIM- Aprovohet Unanimitisht Raporti Final Auditimi i Pasqyrave Financiare në KRU "Radoniqi" SH.A. Gjakovë.

QËNDRIM-Rregullorja Nr.01/2017 për zgjidhjen e Ankesave të Konsumatorëve – të përcillet për aprovim në Mbledhjen e Bordit të Drejtorëve.

QËNDRIM- Rregullorja Nr.02/2017 për procedurat e Lidhjes së Konsumatorëve në Shërbimet e Ujit – Përcillet për aprovim në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve.

QËNDRIM- Rregullorja Nr.03/2017 për procedurat e Ndërrprerjes së Shërbimeve të Ujit - Përcillet për aprovim në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve. Komisioni i Auditimit Shqyrtoi Rregulloren Nr.04/2017 për procedurat e Faturimit për Shërbimet e Ujit dhe njëherit mori **QËNDRIM**-Rregullorja Nr.04/2017 për procedurat e Faturimit për Shërbimet e Ujit - Përcillet për aprovim në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve.

QËNDRIM - Rregullorja Nr.05/2017 për Matjen e Konsumit të Ujit - Përcillet për aprovim në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve.

QËNDRIM -Kërkesa e Kryeshefit Ekzekutiv për ndryshim të emërimit dhe logos së kompanisë përcillet për shqyrtim dhe aprovim në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve.

QËNDRIM-Raporti Final i Zyrës Kombëtare të Auditimit "Menaxhimi dhe Monitorimi i Investimeve Kapitale në Ndërmarrjet Publike" 2014-2016 kalon për aprovim në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve.

Në mbledhjen e 19 mbajtur me date 25.05.2017 u murr;

QËNDRIM- Draft Raporti Auditimi Siguria në Punë e Punëtorëve dhe Objekteve në KRU "Radoniqi" SH.A. Gjakovë, përcillet për komente nga Menaxhmenti

Në mbledhjen e 20 mbajtur me date 22.06.2017 u murr;

VENDIM - Aprovohet Raporti Final për Sigurinë në Punë të Punëtorëve dhe Objekteve në KRU "Radoniqi" SH.A. Gjakovë.

VENDIM - Raporti përmbledhës mbi Implementimin e Rekomandimeve Tetor 2016 – Prill 2017 në KRU "Radoniqi" Sh.A.Gjakovë.

QENDRIM- Autorizohet menaxhmenti i kompanisë për iniciimin e procedurave për plotësim të stafit në zyrën e Auditimit të Brendshëm me pozitën Zyrtar i Auditimit-Asistent.

QENDRIM- Kërkesa nga Kryeshefi Ekzekutiv për shitjen e materialeve(të metalit) që janë jashtë përdorimit në KRU "Radoniqi" sh.a.Gjakovë, përcillet për aprovim në mbledhjen e Bordit të Drejtoreve.

Në mbledhjen e 21 mbajtur me date 24.07.2017 u murr;

QËNDRIM- Draft Raporti Shpenzimet Operative Korrik 2016 - Qershor 2017 përcillet Departamentit Financiar për komente

Në mbledhjen e 22 mbajtur me date 24.08.2017 u murr;

QENDRIM- Draft Raporti Menaxhimi Burimeve Njerëzore përcillet për komente Njesisë së Personelit në Departamentin Administrativ.

VENDIM - Aprovohet unanimitisht Raporti Auditimit Menaxhimi i Shpenzimeve Operative për periudhën Korrik 2016-Qershor 2017 në KRU "Radoniqi" SH.A. Gjakovë përcillet tek Menaxhmenti i kompanisë për zbatim dhe njeherit të plotë Rregullorja mbi Shpenzimet e Parase .

QENDRIM -Kërkesa e KE përcillet për aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtoreve
Mbledhja 23 mbajtur me date 25.09.2017

VENDIM-Raport final Menaxhimi i Burimeve Njerëzore përcillet për komente Njesisë së Pe

QENDRIM- Rregullorja përcillet për diskutim dhe aprovim në mbledhjen e Bordit Drejtoreve.

QENDRIM- Rregullorja përcillet për aprovim në mbledhjen e BtD

Në mbledhjen e 24 mbajtur me date 25.10.2017 u murr;

QENDRIM - Draft Raporti Menaxhimi i të hyrave për periudhën Shtator 2016-2017 përcillet për komente departamentit financiar.

QENDRIM Draft Plan Biznesit 2018-2020 KRU"Radoniqi"sh.a-Gjakovë përcillet për aprovim në BtD.

QENDRIM Rregullorja mbi procedurat e arketimit në portoarka në KRU"Radoniqi"sh.a.Gjakovë përcillet për aprovim në BtD.

Në mbledhjen e 25 mbajtur me date 27.11.2017 u murr;

VENDIM - Apropohet Raporti final Procesi Menaxhimi i të hyrave për periudhën Shtator 2016-2017 dhe i njëjti përcillet për zbatim Departamentit financiar.

QENDRIM Draft Raporti Sistemi për Menaxhimin e Procedurave të Prokurimit përcillet për komente Zyres së Prokurimit.

QENDRIMRaporti TM3 Korrik-Shtator 2017 mbi zhvillimin e aktiviteteve afariste në KRU"Radoniqi"sh.a.Gjakovë përcillet për aprovim në BtD.

Në mbledhjen e 26 mbajtur me date 21.12.2017 u murr;

VENDIM - Aprovohet unanimitisht Raporti final Sistemi për Menaxhimin e Procedurave të Prokurimit përcillet për komente Zyres së Prokurimit.

QENDRIM - Përcillet për aprovim në mbledhjen e BtD.

QENDRIM -Kërkesa e KE përcillet për aprovim në mbledhjen e BtD. Komisioni Auditimit shqyrtoi dhe diskutoi Rregulloren mbi Shpenzimet e Parase KRU"Radoniqi"sh.a-Gjakovë dhe njeherit muarr:

2.1.2 Pasqyra e performances operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe planin e vitit aktual

Bordi në mënyrë të rregullt ka vlerësuar parametrat e performances së Kompanisë. Sa i përket Planit të Vitit 2017, Kompania ka arritur që ti realizoi pjesën më të madhe nga caqet e objektivave të Planit të Biznesit .

Pasqyra e performances operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe planin e vitit aktual

<i>Treguesit kryesor te performances</i>	Caqet e realizuara 2016	Caqet e realizuara 2017	Ndryshimi	Caqet e planifikuara BP 2017	Caqet e realizuara 2017	Ndryshimi
1. Uji i prodhuar në m3	15,247,974	14,981,619	-266,355	15,053,500	14,981,619	-71,881
2. Uji I faturuar në m3	8,017,860	7,963,721	-54,139	8,128,890	7,963,721	-165,169
3. Konsumatorë të regjistruar	34,353	35,887	+1,534	36,804	35,887	-917
4. Nr. I faturave të lëshuara	34,353	35,887	+1,534	36,804	35,887	-917
5. Nr. I kons. që faturohen sipas	33,779	35,316	+1,537	35,700	35,316	-384
6. Uji faturuar për kons. me ujmatësa	7,472,783	7,439,297	-33,486	7,559,868	7,439,297	-120,571
7. Faturimi në Euro	3,791,423	4,034,672	+243,249	3,983,156	4,034,672	+51,516
8. Arketimi nga uji në Euro	3,586,414	3,512,467	-73,947	3,534,117	3,512,467	-21,650
9. Te hyrat tjera operative ne Euro	117,565	77,928	-295,580	60,000	77,928	+17,928
10. Shpenzimet operative	2,846,672	2,934,498	+87,826	2,876,056	2,934,498	+58,442
11. Shlyerja e borxheve ndaj kons.	1,391,857	2,313,103	+921,246	0	2,313,103	+2,313,103
12. Shlyerja e obligimeve nga	0	0	0	0	0	0
13. Parat e gatshme në bank dhe në	942,989	589,027	-353,962	848,352	589,027	-259,325
14. Stoqet	465,373	535,475	+70,102	540,516	535,475	-5,041
15. Llogarit e arketueshme Euro	10,780,673	10,926,268	+145,595	10,278,340	10,926,268	+647,928
16. Llogarit e pagueshme	5,876,723	8,117,330	+5,019,545	3,281,628	8,117,330	+4,835,702
17. Numri I punetoreve	255	260	+5	265	260	+5
18. Numri I ankesave	452	665	+213	600	665	+65
19. Numri total I testeve të realizuara	5,906	2,698	-3,208	1,335	2,698	+1,353
21. Matja e treguesve ne %						
22. Uji I pa faturuar	47%	47%	0	46%	47%	+1
23. Përqindja e faturimit	100%	100%	0	100%	100%	0
24. Përqindja e konsumit të matur	93%	93%	0	93%	93%	0
25. Proporcioni I kons. Me ujmatësa	98%	98%	0	97%	98%	+1
26. Efikasiteti I stafit	7.95	7.52	-0.43	7.20	7.52	+32
27. Shkalla e inkasimit në % (të tërë)	95%	87%	-8%	89%	87%	-2
28. Shkalla e inkasimit në % - amvisni	93%	88%	-5%	80%	88%	+8
29. Shkalla e inkasimit në % - biznese	91%	83%	-8%	85%	83%	-2
30. Shkalla e inkasimit në % - industri	118%	83%	-35%	98%	83%	+15
31. Norma e mbuleses së punes	1.31	1.26	-0.05	1.25	1.26	+0.01
32. Norma e punes	1.38	1.45	+0.07	1.41	1.45	+0.04
33. Shpenz.Operative per Konsumator	6.87	6.60	-0.27	6.51	6.60	+0.09

Prodhimi i ujit në m3 -Prodhimi i ujit në vitin 2017 krahasuar me prodhimin e ujit gjatë vitit 2016 ka rezultuar me zvogëlim prej **266,355 m³**, ndërsa krahasuar me BP ka gjithashtu zvogëlim prej **71,881 m³**. Ky zvogëlim i prodhimit ka ardhur si rezultat i eliminimit të defekteve, çka tregon një sukses sepse me këtë sasi kemi arritur të sigurojmë 24 ore ujë të pijes për konsumator, pastaj kemi bere faturim me te larte si dhe kemi zvogëlim te sasisë se humbjes se ujit te pijes.

Faturimi ne € -Në vitin 2017 faturimi në Euro është më i ulët se ne vitin 2016 për **54,139€**, ndërsa krahasuar me BP 2017 ka rënie në vlerë prej **-165,169 €**. Në rënien e Faturimit ka ndikuar rënia e prodhimit të Ujit dhe rënia e kërkesës së konsumatorëve për uje si dhe eliminimi i defekteve të ujit nga ekipa e mirëmbajtjes.

Arkëtimi në Euro – Në vitin 2017 krahasuar me vitin 2016, vlera e arkëtimit nga uji në Euro ka qenë për **73,947 €** më e ulët, ndërsa për **21,650 €** më e ulët se BP 2016. Ndërsa arkëtimi total edhe nga uji edhe nga te hyrat tjera kur krahasojmë me vitin 2016 ka rënie prej **113,583 €** kurse kur krahasojmë me BP 2017 ka rënie të vogël prej **3,720 €**. Renia e arkëtimit, sidomos kur krahasohet me vitin 2016 ka ndodhur pasi në vitin 2016 Kompania ka arkëtuar borxhe nga Ligji për Faljen e Borxheve.

Shpenzimet Operative -Në vitin 2017 kanë qenë për+87,826 € se vitin 2016, kurse për 58,442 € më i lart se BP 2017, si rezultat i rritjes së aktivitetit të Kompanisë për ngritje të performancës me kushte me të mira të punës. Ngritje ka shpenzimet e mirembajtjes, rrymes, derivateve.

Humbjet e ujit -Në vitin 2017 humbjet e ujit jone 47 % njëjt kanë qenë edhe në vitin 2016, kurse me BP 2017 humbja ishte planifikuar të jete 46% për 1% më pak.

Fitimi operativ – Krahasuar me vitin 2016 fitimi operativ në Euro ka qenë më i ulët për 201,410 € që ka ardhur si rezultat i zvogelimit të arkëtimit, kurse për 62,164 € më i ulët se BP 2017.

Nr. i punëtorëve- Në vitin 2017 krahasuar me Planin e Biznesit të vitit 2017 është më i ulët për -5 punëtorë, ndërsa krahasuar me vitin 2016 ka pas rritje për -5 punëtor .

Nr. i testeve të dështuara - Në vitin 2017 i plotësojnë standardet e kërkuara sipas IKSHP. Numri i tyre gjithmonë tregon treguesin -0%.

Nr. i konsumatorëve- Në vitin 2017 krahasuar me numrin e konsumatorëve në vitin 2016 ka rezultuar me rritje prej +1,534 ndërsa krahasuar me BP 2017 numri i konsumatorëve ka rënie prej -917 konsumatorë pasi nuk kemi bërë një parashikim të sakt.

Parat e gatshme në bankë dhe në arkë- Me 31.12.2017 paraja ka qenë 589,027 € që është për -355,962 € më i ulët se në vitin 2016 dhe për -259,325€ më i ulët se BP 2017, si rrjedhojë e rritjes të afarizmit në Kompaninë dhe pagesave të fundvitit.

2.1.3 Ngjarjet të cilat ndikojnë në të ardhmen e ndërmarrjes

Me qëllim që shërbimi të jetë sa më afër konsumatorit, kompania ka vazhduar që të hapë porto-arka dhe këtë vitë si edhe vitin e kaluar ka rritë numrin e tyre në lagje me dendësi më të madhe të konsumatorëve. Këto arka janë si strategji e kompanisë që nga viti 2012, të i largon inkasatet-arketuesit nga terreni dhe shkallë shkalle të jone deri të ndërprerja e pagesave në kesh .

Kjo është edhe një formë e shfrytëzimit më racional të punëtorëve në lexime të ujëmatësve dhe të evitohet mundësia e inkasimit përmes keshit si dhe zvogëlon mundësinë e keqpërdorimit të parave .

Me qëllim të reduktimit të kyçeve ilegale, kyçeve të dyfishta dhe konsumatorëve fiktiv, janë angazhuar ekipe mobile për verifikim të gjendjes në terren. Veprimet e tilla kanë efektin e dyfishtë në: korrigjimin e shënimeve bazë dhe në uljen e humbjeve administrative /komerciale.

Me qëllim që të ulët shkallën e ujit të pa-faturuar dhe njëherit të rritet performanca e përgjithshme e Kompanisë, Menaxhmenti i KRU-se ka realizuar strategji të planifikuara që nga

viti 2012, leximin e ujmatesave kryesor dhe të menaxhimit të zonave, përmes specialistëve, dhe angazhimit të inkasantëve-arkëtuese që do të vendosen në secilën zonë për arkëtimin e detyruar të faturave të pa paguara dhe të borxheve të pa arkëtuara me Saldo 31.12.2017.

Realizimi i Projektit - trajtimi i ujërave të zeza, është një ndër ngjarjet më të madhore që do të ndikojë në të ardhmen e Kompanisë. Projekti vlerësohet të filloi të realizohet gjatë vitit 2015 nga mjetet donacioni i KëF-Bankës, KK-Gjakovë dhe CDI –së. Me këtë projekt, Kompania do të arrijë që veprimtarinë e sajshërbyese në këtë drejtim ta realizoi komfor standardeve evropiane për trajtimin e ujërave të zeza. Në këtë drejtim nga Operatori Ekonomik i përzgjedhur si konsulent në implementimin e këtij projekti, ka filluar me punën me angazhimin e konsulentit në sektorin teknik, i cili ka filluar të punoi në implementim që nga fillimi i vitit 2016.

Janë ndërru terenet e inkasantëve në mënyrë që të përfshihen numër më i madh i konsumatorëve. - Kontrollë të konsumatorët rreth eliminimit të keqperdorimeve të ujit. Janë hap edhe porto arka tjera. Me rritjen e numrit të porto arkave konsumatorëve ju ofrohet mundësia e pagesës së obligimeve të ujesjellsit sa më afër tyre. Pjesmarrje në takimet mujore në Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve, ku pjesmarrës në këto takime janë zyrtar nga ZRRUK dhe përfaqësues nga Kuvendet Komunale të zonës së operimit të KRU "Gjakova" sh.a. Vizita të herë pas herëshme në njësit operative me udhëheqësit e njësive lidhur me rritjen e efikasitetit rreth rritjes së faturimit, inkasimit dhe kontrollës të konsumatorët. Takime me përfaqësuesit e lagjeve, fshatrave, ndërtesave kolektive për mundësinë e gjetjes së formave dhe mundësive për fillimin e nënshkrimit të kontratave për riprogramim të borxheve.

Top çështjet tjera të cilat do mund të përcaktojnë të ardhmen e Kompanisë janë :

- Krijimi në vazhdimësi i kushteve më të volitshme të infrastrukturës ujore dhe të kanalizimit për konsumatorët tonë.
- Përmirësimi i Raporteve afariste me ARRU-se, MMPH, etj. Zgjidhja e çështjes financiare të obligimeve financiare të rregullta mujore ndaj tyre.
- Arkëtimi i borxheve të vjetra sipas Saldo 31.12.2016, sipas Ligjit në mënyrë të detyruar.
- Realizimin e Marrëveshjeve për borxhet e pa paguara, me konsumatorët borxhli për riprogramim të borxheve ndaj KRU-së.
- Rritja e shkallës së Leximin-Faturimit në masën +1.38 % në vitin 2017 dhe të inkasimit-arkëtimin të Faturave të vitit 2017 në minimum +1.48 % të tyre nga konsumatorët dhe një pjesë të Borxheve të pa paguara nga konsumatorët sipas Saldo 31.12.2016.
- Paisja me ujëmatës e të gjithë kategorive të konsumatorëve.
- Lidhja e Marrëveshjeve të shërbimeve me konsumatorët.
- Përmirësimi i menaxhimit të sistemit të furnizimit me ujë, mbajtja nën kontroll e nivelit të prodhimit i cili nga ana tjetër është i lidhur me koston e prodhimit, në veçanti shpenzimet e energjisë elektrike të cilat shpenzime janë të lidhura direkt me nivelin e prodhimit, ulja e nivelit të prodhimit ndikon edhe në uljen e kostonë së këtyre shpenzimeve.
- Zvogëlimi i humbjeve teknike dhe komerciale të ujit të pijes.
- Angazhimi maksimal i Sektorit të Planifikimit dhe Zhvillimit në hartimin e Projekteve investive kapitale, për aplikimin tek aksionari Qeveria e Kosovës, Donatorët, Bankat, etj.
- Realizimi i Projektit "Ndërtimi i Impiantit të Ujrave të Zeza"
- Zhvillimi i raporteve të vazhdueshme me KK-Gjakovë, Rahovec dhe Prizren.
- Rritjen e investimeve kapitale nga mjetet vetanake.
- Gatishmëria teknike dhe furnizimi i duhur me makineri të rëndë për nivelin e duhur të operativës.
- Realizimi i Projektit Faza e dytë

2.1.4 Pasqyrë e të priturve për vitin e ardhshëm

Kompania do të vazhdoi punën në vitin e ardhshëm në mirëmbajtjen dhe aktivitetin e avancimit të funksioneve të operimit si dhe të realizoi treguesit operativ dhe financiar sipas objektivave të përcaktuara në Plan Biznes 2018:

- Rritja e prodhimit të ujit për +3.31%
- Zvogëlimi i humbjeve të ujit në rrjetë për-1 %
- Rritjen e sasisë së ujit të shitur, të faturuar për + 1.59 %
- Rritjen e arkëtimit të faturuar në +1 %,
- Rritja e arkëtimit të borxheve në masën prej +4% te saldo borxhit 31.12.2016
- Rritjen e shpenzimeve jo operative për + 4.05%
- Investime vetanake kapitale dhe nga donacionet në vitin 2017 në shume prej 3,571,649€

Në aspektin e aktiviteteve thelbësore të biznesit në vitin 2017 veprimet e duhura do të jenë ato në favor të punëve operative në terren: Përmbushja apo tejkalimi i niveleve të aktiviteteve të planifikuara në mirëmbajtje, Furnizimi i konsumatorëve me ujë cilësor, - mirëmbajtja e funksionalitetit të mbarë infrastrukturës, investime të planifikuara dhe aty ku mundë të shfaqen, e ku do të vlerësohet se mundë të vihet në rrezik biznesi jonë. Reduktimi në masë të madhe i rrezikut nga përmytjet nga kanalizimi fekal dhe atmosferik gjatë periudhës të reshurave intensitet dhe kohëtë tejzgjatur. Me qëllim të sigurimit të cilësisë më të mirë të shërbimeve për klient, KRU-ja do të veprojë në favor të ndërmarrjes së masave të shpejta dhe efikase ndaj kërkesave të arsyeshme dhe nevojave tjera të klientëve . Të arrijmë të përmbushim kërkesat dhe ankesat e konsumatorëve në afatin minimal të mundshëm . Nga aspekti i pasqyrave financiare në vitin 2017 , Kompania do të orientohet drejt krijimit të profitit si ndërmarrje publike me tarifa të rregulluara . Kompania do të synoj që të mbulojë të gjitha kostot operative të Ndërmarrjes me përjashtim të amortizimit, me të ardhura nga parat e gatshme. Do të bëjmë zvogëlimin e shpenzimeve të planifikuara për energji dhe karburante, si dhe do të bëjmë planifikimin e investimeve vetanake si dhe të aplikojmë për grante në Qeverinë e Republikës së Kosovës me projekte sipas planifikimit nga Sektori për Planifikim dhe Zhvillim. Projektet më të mëdha për ndërtimin dhe ristrukturimin e sistemit në përgjithësi të KRU-së do mundohemi ti realizojmë edhe përmes aplikimit për kredi të buta në Banka ndërkombëtare, Donacionet, etj.

Ofrimi i shërbimeve kualitative dhe të besueshme për konsumatorët është një ndër detyrat kryesore të kompanisë. Në këtë drejtim angazhimi profesional nga ana e punëtorëve në një anë dhe investimet në rritjen e kapaciteteve të prodhimit, leximit-faturimit dhe inkasimit-arkëtimit në anën tjetër, do të ndikoi në rritjen e besueshmërisë së KRU "Radoniqi" Sh.A. tek konsumatorët , e që janë në pajtueshmëri të plotë me misionin dhe vizionin e Kompanisë .

Ngritja e të hyrave në periudhën vijuese mbledhja e borxheve nga vitet paraprake, do të mbetet një ndër prioritet më të larta të menaxhmentit. KRU-ja ka dy prioritet kryesore për të ngritur inkasimin-arkëtimin:

Përmes Marrëveshjeve për Ri-programimin e borxheve në mes të KRU-së dhe konsumatorëve borxhli që të paguajnë borxhet e vjetra sipas Salldos 31.12.2016 dhe faturat mujore te vitit 2017, e në rast dështimi opsion i fundit do jetë zgjidhja e kësaj çështjeje përmes; **Arkëtimit te detyruar** përmes çkyqjes duke bere ckyqjen nga rrjeti dhe, **kërkesa per permbarimin e borxheve permes Permbaruesit Privat**. Planifikohen qe per vitin e fundit sipas LMD te percillen te gjithë konsumatorët borxhli te cilet nuk kanë paguar borgjet , tek permabruesit privat.

Ne pergjithësi kompania në vitet e ardhshme do të krijoj një ambient për investime në zhvillimin profesional të punëtorëve sipas Sektorëve te caktuar dhe ti motivoi në arritjen e përfomances së standardeve më të larta si dhe të krijoj një ambient të sigurt pune.

Do të vazhdojë me ndërtimin dhe zhvillimin e raporteve korrekte, në radhë të parë me aksionarin tonë Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe me palët e interesit posaçërisht me ARRU, MZHE, MMPH, Kuvendet Komunale, Donatoret, etj.

2.2. Informacione ne lidhje me kapitalin dhe dividenden

Procesi i menaxhimi të pasurisë apo asetëve joqarkulluese, është konstatuar se në përgjithësi është zhvilluar në pajtim të plotë me Ligjin për të Ardhurat e Korporatave me nr.03/L-162, Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK 16 dhe SNK 36), Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë me nr. 03/L- 048, udhëzimet administrative dhe shpjegimet publike. Rivlerësimi i asetëve në KRU "Radonqi" Sh.A.-Gjakovë , për herë të fundit është kryer nga vlerësues të jashtëm në vitin 2007. Në pajtim me ligjet e aplikueshme, ky proces është kryer përmes një kompanije të licencuar për vlerësim dhe atë paraprakisht të lejuar nga Aksionar. Kapitali themelor i Ndërmarrjes në momentin e regjistrimit ka qenë 25.000 € aksione me vlerë nominale prej 1 € secili. Aksionar i vetëm i K.R.U. "Radonqi" Sh.A. Gjakovë është - Qeveria e Republikës së Kosovës .

Të gjitha ndryshimet e kapitalit themelor , bëhen sipas përcaktimit në Ligjin Nr.02/L123 "Për Shoqerit Tregtare" ku përfshihet shuma-parapagimi, raporti me vlerën nominale, rritja e kapitalit themelor, zvogëlimi i kapitalit themelor, ndarja e aksioneve, rigrupimi i aksionit, anulimet që nuk ndryshojnë kapitalin themelor, riblerja ose revokimi i aksionit.

Struktura e Kapitalit	Kapitali Aksionarnë Euro
Kapitali aksionar në para	25,000
Rezervat e rivlerësimit	31,576,051
Humbjet e bartura	-2,459
Fitimit financiare e vitit 2016	+13,498
Total ekuiteti dhe kapitali	31,612,090
Bilanci deri me 31.12.2017	31,612,090

Gjatë vitit 2017 Kompania i ka mbyllur Pasqyrat Financiare përkatësisht Pasqyren e te Ardhurave me fitimi, ku shihet edhe në tabelarin e mësipërm te pozicioni fitimet financiare për vitin 2017

2.2.1 Kredit e rëndësishme të nënshkruara apo të paguara gjatë vitit

Gjatë vitit 2017 nuk kemi hyrë në marrëdhënie të reja kreditore .

2.2.2 Investimet e rëndësishme të bëra gjatë vitit

KRU "Radoniqi" Sh.A. gjatë vitit 2017 ka bërë investime të shumta bazuar në planin e tij zhvillimor. Investimet e rëndësishme të bëra gjatë vitit 2017 janë realizuar me rregull dhe sipas afateve siç janë përcaktuar në Planin e Biznesit dhe në planin individual të Sektorit për Zhvillim dhe Projekte investive. Më poshtë janë përmendur projektet investive dhe burimet e financimit të projekteve në mënyrë të përgjithësuar, ndërsa statusi i tyre dhe detajet janë pjesë e këtij raporti. Gjatë vitit 2017 Kompania ka investuar në projektet e paraqitura në vijim nga mjetet e realizuara nga; donatorët, mjetet vetanake, dhe nga donacionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës;

Me investimet nga Donacionet është bërë realizimi i projekteve

Investimet nga donacionet e Qeverisë, Bashkimi Evropian , CDI ,Komuna për vitin 2017

- Projekti LOTI 2 "Linja e ujit te pijes nga baseni i Radoniqit, linja e Anadrinit , linjat dhe infrastruktura mbështetëse, Faza e dytë. Totali i donacionit - Për 2017: **901,134.63 €**.
- Projekti LOTI 3 Kanali Derivues i Bazenit të Radonqit ,Linja dhe Infrastruktura Mbështetëse është financuar nga MZHE në Totalin e Donacionit -Për 2017 :**500,311.23 €**.
- Rehabilitimi i sistemeve rurale të ujësjellësit në zonën e shërbimit të KRU " Gjakovë " Sh.A Gjakovë, për të gjitha fshatrat te investuara nga CDI. Totalin e Donacionit -Për 2017 Lot 1. dhe Lot 2 **Vlera 1,081,206.85 €**.

Tabelari – Projektet e realizuara nga Donacioni nga Qeveria e Kosovës ,CDI ,Komuna për vitin 2017

Emri i Projektit	Vlera Euro	Operatori Ekonomik i kontraktuar
Lot 2: Linja e ujit te pijes nga baseni i Radoniqit, linja e Anadrinit , linjat dhe infrastruktura mbështetëse, Faza e dytë.	Donacioni nga MZHE Totali i donacionit – Për 2017 901,134.63 €	"PEVLAKU" shpk Kontrata te realizohet per 3 vite të realizohet në vlerë:2,770,512.96 €
Lot 3 : Kanali derivues i basenit te Radoniqit, linja dhe infrastruktura mbështetëse	Donacioni nga MZHE Totali i donacionit - Për 2017 500,311.23 €	"PEVLAKU" shpk Kontrata të Realizohet per 3 vite në vlerë: 1,739,519.68 + 173950.88= 1,913,470.56 €
Rehabilitimi i sistemeve rurale të ujësjellësit në zonën e shërbimit të KRU " Gjakovë " Sh.A Gjakovë, për të gjitha fshatrat te investuara nga CDI Lot 1. dhe Lot 2	Donacioni nga DORCH/CDI Totali i donacionit i realizuar - Për 2017 1,081,206.85 € Mbetet për me u realizuar për 2018 360,402.28 €	KWE Kontrata bazë në vlerë: Lot 1 537.456,59 € Puna + Materiali 155,232.00 € Gypat 523,265.00 € Totali lot 1 1,216,039.50 € Totali lot 2 235,569.63 € 1,441,609.13 €
TOTALI	2,482,652.71	

Investime vetanake të Kompanisë me participim ne projekte te financuara nga Qeveria e Kosovës është bërë realizimi i projekteve

Emri i Projektit	Vlera Euro	Operatori Ekonomik i kontraktuar
Lot 1: Linja e ujit te pijes nga baseni i Radoniqit, linja e Anadrinit , linjat dhe infrastruktura mbështetëse, Faza e dytë.	Mjete vetanake KRU "Radoniqi" 687,590.18 € Donacioni nga K.K. Prizren 100,000.00 € Donacioni nga K.K. Rahovec 100,000.00 € €	"PEVLAKU" shpk Kontrata te realizohet per 3 vite të realizohet në vlerë: 2,236,970.17 €
Totali - Për 2017	887,590.18	

Gjithsejtë investime vetanake në projekte ne participim me Qeverinë dhe komunat Prizren 100,000.00 € dhe Rahovec 100,000.00 €

$$687,590.18 \text{ €} + 200,000.00 \text{ €} = 887,590.18 \text{ €}$$

Të gjitha projektet janë kryer brenda afatit optimal, kurse Komisioni i BtD për projekte kapitale ka përcjell statusin e projekteve gjatë mbledhjeve që janë mbajtur gjatë vitit 2016

Investimet kapitale për përmirësimet infrastrukturore dhe jo infrastrukturore te realizuara gjatë vitit 2017 me investime vetanake dhe Grand Qeveritar

Nr.r.	Përmirësimet infrastrukturore dhe jo infrastrukturore	Te realiz.2016
1.	Objektet ndertimore	221,178
2.	Rrjeta e ujesjellesit	574,138
3.	Ujmatësit	9,193
4.	Investime në projekte	0
5.	Investimet në Kanalin Derivues	0
6.	Investime ne rrjetin e Kanalizimit	0
7.	Paisje elektrike-mekanike	222,834
8.	Kamionat dhe automjetet	98,677
9.	Paisjet kompjuterike	117,823
10.	Paise për zyre	7,964
11.	Paisje per filtrimin e ujit	0
12.	Investimet në vijim	2,319,841
	GJITHSEJT:	3,571,648

2.2.3 Dividentet e paguara gjatë vitit

Gjatë vitit 2017 nga KRU"Radoniqi", nuk është kërkuar të paguajnë dividend nga Qeveria e Republikës së Kosovës .

2.3 TË DHËNAT PËR DREJTORËT JO EKZEKUTIV

2.3.1 Emrat e drejtorëve të bordit të drejtorëve gjatë vitit ,duke përfshirë kompensimet ,shpenzimet dhe pagesat për shërbimet e ndërmarrjes

Në KRU "Radoniqi"Sh.A Gjakovë shpërblimi për Drejtorëte Bordit, që nga fillimi i konstituimit të BtD e deri me raportimin, është bërë komfor Vendimit Nr.07/56 datë , 18.02.2009 - Mbi lartësinë e kompensimit të anëtarëve të bordeve të ndërmarrjeve publike qendrore, sipas kategorizimit të vendosur nga Akcionari - Qeveria Republikës së Kosovës,

Me Vendimin nr. 05/54 të datës 24.10.2016 Qeveria e Kosovës në bazë të Konkursit të shpallur për Drejtorë në Bordin e Ndërmarrjeve Publike në KRU"Radoniqi" Sh.A.-Gjakovë emëron Bordin e ri me këta Kandidat ;

Fatos Koshin	Kryesues i Bordit të Drejtorëve . Kompensimet për shërbimet e Ndërmarrjes për vitin 2017 - neto 4,646 €.
Arbresha Kuqi	Anëtar i Bordit të Drejtorëve si dhe Kryetari i Komisionit të Auditimit. Kompensimet për shërbimet e Ndërmarrjes për vitin 2017- neto 4,432 €
Isuf Asllani	Anëtar i Bordit të Drejtorëve i emëruar me Vendimin e Qeverisë Nr. 04/70 të datës 15.-1.2016 . Kompensimet për shërbimet e Ndërmarrjes për vitin 2017- neto 3,301 €
Xhevdet Morina	Anëtar i Bordit të Drejtorëve si dhe Kryetari i Komisionit të Auditimit. Kompensimet për shërbimet e Ndërmarrjes për vitin 2017 - neto 4,124 €
Shpat Mejzini	Anëtar i Bordit të Drejtorëve . Kompensimet për shërbimet e Ndërmarrjes për vitin 2017 - neto 3,304 €,
Zeqir Fetoshi	Anëtar i Bordit të Drejtorëve si dhe anëtar i Komisionit të Auditimit. Kompensimet për shërbimet e Ndërmarrjes për vitin 2017 -neto 4,124 €,

2.3.2 Numrin e takimeve të bordit gjatë vitit dhe numrin e pjesëmarrjes së drejtorëve në takimet e bordit

Faturimi – Në vitin 2017 faturimi në Euro është më i ulët se ne vitin 2016 për **54,139€**, ndërsa krahasuar me BP 2017 ka rënie në vlerë prej **-165,169 €**. Në rënien e Faturimit ka ndikuar rënia e prodhimit të Ujit dhe rënia e kërkesës së konsumatorëve për uje si dhe eliminimi i defekteve të ujit nga ekipa e mirëmbajtjes.

Arkëtimi në Euro dhe në % – Krahasuar me 2016 vlera e arkëtimin në euro ka qenë më e ulët për -369,527€ ,ndërsa me përqindje ka rezultuar me një ulje -11 % ,ndërsa krahasuar me BP shkalla e arkëtimin gjatë vitit 2016 në Euro ka qenë për -3,722 € më e ulët ,ndërsa në përqindje ka qenë më e lartë për +2-% me BP 2017. Rënia më e madhe e arkëtimin duke krahasuar me vitin 2016 ka ndodhur pasi në vitin 2016 ka pasur sukses ligji për faljen e borxheve dhe ka ndikuar qe arketimi ne vitin 2016 të jetë më i lart në vlerë dhe gjithashtu edhe në përqindje.

Shpenzimet Operative - Gjatë vitit 2017 shpenzimet operative janë për+58,442€ më të larta se me BP 2017, ndërsa nëse krahasojmë me vitin 2016 shpenzimet operative kanë pësuar rritje prej +87,826 €. Shpenzimet operative janë më larta se viti 2015 dhe BP i vitit 2016 ,është bashkëfinancimi nga buxheti i Kompanisë ne realizimin e Projekteve të mëdha të cekura në këtë raport ,ndërtimi me mjete vetanake të infrastrukturës ujore , infrastrukturës rrugore , ndërtimi dhe renovimi i infrastrukturës së objekteve të kompanisë,dukurit tjera që paraqiten në veprimtarinë e Kompanisë e sidomos ; Rritjes së inflacionit, rritjes së vazhdueshme të çmimit të energjisë elektrike, kemikateve, karburanteve te naftës, mirëmbajtja e pajisjeve dhe rrjetës. Pjesën më të madhe të shpenzimeve e përfshijnë shpenzimet e personelit (përfshin pagat, mëditjet, bonuset, trajnimet),shpenzimet e mirë mbajtjes dhe riparimeve (përfshin pjesët e vogla për riparim, mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, mirëmbajtja e automjeteve etj), shpenzimet e energjisë elektrike, shpenzimet e derivateve (përfshin naftën

dhe benzinës për Kompaninë), shpenzimet e kemikaleve (përfshin alumin sulfatin, klor i gazet, klor i lënget, kloruri i hekurit dhe karboni aktiv), si dhe shpenzimet tjera (përfshin shpenzimet administrative, regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve,taksat për licencim të shërbimeve ZRRUM, taksa e ShUKOS-it, taksa për shfrytëzimin e ujit MMPH, shërbimet nga palët e treta).

Humbjet e ujit në %- Në vitin 2017 humbjet e ujit jene 47 % nejt me vitin 2016, kurse me BP 2017 humbja ishte planifikuar te jete 46%, pra nuk e kemi realizuar BP për 1%. Menaxhmenti në vitin 2018 ka marre detyre që me aktivitetet e shtuara ne teren nga ane kontrolles dhe ekipit te mirembajtjes te ule humbjet sipas biznes planit.

Fitimi operativ – Krahasuar me 2016 Fitimi Operativ në euro ka qenë më i ulët për -201,410€, ndërsa krahasuar me BP 2017 fitimi operativ gjatë vitit 2017 në Euro ka rezultuar gjithashtu me i ulët prej -62,164 €.

3.5.3 Çfarë ndryshime janë paraqitur gjatë aktiviteteve ,operimeve dhe ambientit të cilën e rrethon ndërmarrjen që nga përgatitja e planit të biznesit .Si do të ndikojnë këto ndryshime (nëse ka) në arritjen e objektivave të planit të biznesit

Gjatë aktiviteteve ,operimeve menaxhmenti I Kompanisë synon të realizon objektivat e Planit të Biznesit si dhe të përmirësoi edhe më tej performancën e Kompanisë në rritjen e të hyrave të Kompanisë si bazë themelore e krijimit të mundësive financiare të vetë ekzistimit dhe të investimeve kapitale përmes mjeteve vetanake. Në këtë rrugëtim gjatë aktiviteteve drejt realizimit të PB janë paraqitur disa ndryshime , si ; Është paraqitur nevoja qe përsëri te vazhdoje me hapjen e portoarkave në disa lagje me dendësi më të madhe të konsumatorëve;Funksionimin e detektorëve si dhe trajnimi I stafit në këtë drejtim për aftësimin e tyre në përdorimin e aparaturës (detektorëve) si dhe përdorimi i të njëjtave në teren; Matjet komerciale përmes leximit të të dhënave komulative të ujëmatësve kryesor dhe shtëpiak në mënyrën elektronike përmes datalogerëve ; Përmes organizimit të ekipeve shtesë është arritur të bëhet identifikimi I humbjeve administrative dhe komerciale të ujit ; si dhe bashkëpunimi I drejtpërdrejtë dhe permanent I institucioneve të pushtetit lokal të Komunave të cilat operon Kompania .

Me këto aktivitete është arritur që Kompania me mjete vetanake të siguroi që të ketë ndryshime në realizimin e Planit të Biznesit në ambientin që rrethon Kompaninë edhe në përmirësimin e kushteve të punës për punëtorët në kompani . Është arritur të ndërtohen ,objekti administrativ në Digë ,renovimi i objektit administrativ në Gjakovë ,ndërtimi i objekteve të stacionit të pompave shtytese ,sigurimet shëndetësore te punëtorve të KRU,,Radoniqi''sha , duke u realizuar në këtë aspekt të Planit të Biznesit për plotësimin e kushteve të punëtorëve realizuar një hapësirë më e madhe e punës një pastërti dhe komoditet në është arritur një efikasitet më i madh i punës si në aspektin kualitativ dhe kuantitativ si dhe kushte më të mira të punës realizimin e një hapësire më të madhe të punës për punëtorët si dhe është ofruar një përkujdesje dhe ndihmë në drejtim të realizimit të sigurimit shëndetësor . Është realizuar rritja e blerjes së automjeteve me qëllim që të realizohet më lehtë për punëtorin puna në teren .

3.6. SHPENZIMET KAPITALE DHE TË PROJEKTEVE

Investimet e rëndësishme të bëra gjatë vitit 2017

Kompania gjatë vitit ka bërë investime të shumta bazuar në planin e tij zhvillimor .Investimet e rëndësishme të bëra gjatë vitit 2017 janë realizuar me rregull dhe sipas afateve siç janë përcaktuar në Planin e Biznesit dhe në planin individual të Sektorit për Zhvillim dhe Projekte investive .Më poshtë janë përmendur projektet investive dhe burimet e financimit të projekteve në mënyrë të përgjithësuar ,ndërsa statusi i tyre dhe detajet janë pjesë e këtij raporti.

Gjatë vitit 2017 –ka investuar në projektet e paraqitura në vijim nga mjetet e realizuara nga donacionete Qeverisë së Republikës së Kosovës ;

Investimet nga mjetet -donacionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës ,CDI

- Projekti LOT 2 "Linja e ujit te pijes nga baseni i Radoniqit, linja e Anadrinit , linjat dhe infrastruktura mbështetëse, Faza e dytë. *Totali i donacionit* - Për 2017 (901,134.63 €)
- Projekti LOT 3 "Kanali Derivues i Basenit të Radonqit ,Linja dhe Infrastruktura Mbështetëse është financuar nga MZHE në Totalin e Doanacionit Për 2017 (500,311.23 €)

Me Investime vetanake të Kompanisë me participim ne projekte te financuara nga Qeveria e Kosovës është bërë realizimi i projekteve

- Projekti LOT 1 "Linja e Ujit te pijes nga baseni i Radoniqit, Linja e Anadrinit,Faza e dytë" **(687,590.18 €).**
- Projekti LOT 1 "Kanali Derivues i basenit te Radoniqit, Faza e dytë(Donacion nga Komunitat e Prizren **100,000.00 € dhe Rahovec 100,000.00 €.**

Gjithsejtë investime vetanake në projekte Investive. 687,590.18 + 200,000.00 = 887,590.18 €

3.6.1 Lista e investimeve kapitale

Gjatë vitit 2017 në KRU" Gjakova" janë bërë investime të konsiderueshme në rrjetin e ujësjellësit në Gjakovë dhe dy Njësit tjera në Rahovec dhe Prizren, si nga ana e Kompanisë ashtu edhe nga ana e Komunave .Në kuadër të përmirësimit të furnizimit të qytetarëve me ujë ,rritjes së konsumatorëve ,zhvillimit të infrastrukturës ujore ,kanalizimit ,te infrastrukturës së objekteve ,mirëqenies së punëtorëve etj. Kompania ka bërë disa investime në rrjetin e ujësjellësit sidomos në zgjerimin e zonës së shërbimit dhe në rritjen e presionit në rrjetin e ujësjellësit . Në vazhdim po paraqesim investimet e realizuara nga ana e Kompanisë që kanë të bëjnë me implementimin e projekteve :

Tabela - Lista e investimeve kapitale -2017

Lista – OBJEKTET NDERTIMORE	Vlera €
Renovimi i objektet në Drejtori	221,178 €
TOTALI OBJEKTET NDERTIMORE	221,178 €
Lista – RRJETI I UJËSJELLËSIT	
Investime ne Rrjetin e Ujesjellesit	574,138
TOTALI I RRJETIT TE UJSJELLESIT	574,138
Lista – UJMATESIT	
Instalimi i ujematesve tek konsumatorët e ndryshëm	9,193
TOTALI UJMATESIT	9,193
Investimet ne Vijim-Faza e II-te e përpunimit të Ujit	2,319,841
Totali- Investimet ne Vijim-Faza e II-te e përpunimit të Ujit	2,319,841
Lista - Pajisje elektro mekanike	
Rehabilitimi i st.pompave ne Damjan, Opterushë, Senoc, Drenoc Donacion nga CDI-ja	152,934
Rehabilitimi i st.pompave ne Brovin dhe Mulliq Donacion nga CDI-ja	42,541
Eliminimi i avarisë në stacionin e pompave Sopot	6,243
Kalibrimi i ujematesve-Donacion nga INSA Beograd	5,924
Rehabilitimi i stacionin te pompave ne Dushkaj	3,174
Pajisjet tjera elektro mekanike	12,018
TOTALI PAISJET ELEKTRO MEKANIKE	222,834
Lista –Automjetet dhe Kamionat	98,678
TOTALI Automjetet dhe Kamionat	98,678
Lista - Paisjet IT	
INS-Furnizim me softuer per GIS sistemin	112,720
Pajisje tjera kompjuterike	5,104
TOTALI I PAISJEVE IT	117,824
Lista - MOBILJE DHE PAISJE PËR ZYRE	
Pajisje për zyre	7,964
TOTALI I MOBILJEVE DHE PAISJEVE PËR ZYRE	7,964
TTOTALI I INVESTIMEVE 2017	3,571,649

3.6.2 Komentet në progresin e projekteve kapitale të ndërmarrjes ,duke përfshi : Komente dhe vonesa administrative ,vonesa në prokurim,apo ndonjë ndryshim i kostove ne implementimin e projekteve .

Në realizimin e projekteve kapitale gjatë vitit 2017 Ndërmarrja ka treguar një progres të dukshëm. Projektet e planifikuara për vitin 2017 themi se pothuajse në tërësi janë realizuar ku në këtë realizim ka ndikuar rritja e të hyrave si rezultat i rritjes së arkëtimit si dhe të hyrave tjera . Projektet kapitale janë implementuar një pjesë nga mjetet tona vetanake , Grandet e aksionarit –Qeverisë së Kosovës, CDI, si dhe komunat e Regjionit qe furnizon Kompania .Sa i përket procedurës së implementimit (vonesa administrative ,vonesa në prokurim apo ndonjë ndryshim tjetër i kostove gjatë vitit 2017 mund të themi se të gjitha projektet janë realizuar pa ndonjë ngecje të qenësishme që do të pengonte realizimin e këtyre projekteve kapitale .

Projektet e investuara nga mjetet donacionet e Qeverisë së Kosovës – mund të themi se procedurat administrative dhe të prokurimit si dhe kostove të shpenzimeve janë realizuar në tërësi . Falënderuar stafit të prokurimit KRU-ja ka arritur që për vitin 2017 ti realizoi 100% të mjeteve nga donacionet e ndara për Kompaninë .

3.7 PRESPEKTIVA PËR VITIN E ARDHSHEM

3.7.1 Te paraqitet një skicë gjithëpërfshirëse e planit të biznesit për vitin e ardhshëm dhe të identifikohen objektivat kryesore;

Plani i Biznesit 2018-2020 definon çart orientimet zhvillimore të Kompanisë dhe definon çartë objektivat dhe rezultatet e pritshme duke marrë për bazë edhe rezultatet e arritura në periudhën paraprake .

Plani është përgatitur duke pas parasysh gjendjen ekzistuese të Kompanisë ,trendët e zhvillimit të sektorit të ujit në Kosovë për të adaptuar praktikat më të mira të njohura për një zhvillim të qëndrueshëm të Kompanisë .

Por gjithashtu është marrë për bazë edhe ambienti ekonomik dhe social në regionin tonë .

Plani i Biznesit 2018-2020 definon rrugën e zhvillimit të Kompanisë duke marrë parasysh përparësitë dhe rreziqet për realizimin e suksesshëm që do të rezultojnë me një arritje të vet qëndrueshmërisë financiare të Kompanisë .Parametrat operativ dhe financiar janë analizuar në mënyrë që të jenë të arritshme duke lënë mundësinë e tejkalimit të tyre –uljen e tyre pa e dëmtuar funksionimin dhe ofrimin sa ma cilësor të shërbimeve ndaj konsumatorëve ,të jenë sa më lartë realitetit dhe parametrave të arritshëm.

Ky Plan merr parasysh të gjithë faktorët dhe rrethinën që ka ndikim në punën e Kompanisë.

Plani është i orientuar fuqishëm në drejtim të mundësive vetanake financiare dhe të donatorëve ku realizim i këtij plani e sidomos planit të investimeve është i varur edhe nga përkrahja që do të sigurohet nga donatorët ,institucionet qendrore dhe lokale .

Bordi i Drejtorëve ,Menaxhmenti si dhe të gjithë të punësuarit do të jenë të angazhuar maksimalisht që me punën e tyre të realizojnë objektivat që dalin nga ky plan , në mënyrë që Kompania të arrij një qëndrueshmëri financiare që të ofroj shërbime cilësore për konsumatorët.

Në vazhdim po i paraqesim në formë tabelore treguesit kryesor operativ dhe financiarë të performancesBP.

Treguesit kryesor te performances		Caqet e realizuara 2016	Caqet e relizuara 2017	Caqet e planifikuara BP 2017	Caqet e planifikuara BP 2018
1.	Uji i prodhuar në m3	15,247,974	14,981,619	15,053,500	15,494,902
2.	Uji i faturuar në m3	8,017,860	7,963,721	8,128,890	8,367,247
3.	Konsumatorë të regjistruar	34,353	35,887	36,804	37,108
4.	Nr. I faturave të lëshuara	34,353	35,887	36,804	37,108
5.	Nr. I kons. që faturohen sipas leximit të Ujm.	33,779	35,316	35,700	36,366
6.	Uji faturuar për kons. me ujëmatës	7,472,783	7,439,297	7,559,868	7,781,540
7.	Faturimi në Euro	3,791,423	4,034,672	3,983,156	4,099,951
15.	Arketimi në Euro	3,586,414	3,512,467	3,534,117	3,525,958
9.	Te hyrat tjera operative ne Euro	117,565	77,928	60,000	60,000
10.	Shpenzimet operative	2,846,672	2,934,498	2,876,056	3,058,366
11.	Shlyerja e borxheve ndaj kons.	1,391,857	2,313,103	0	0
12.	Shlyerja e obligimeve nga kreditorët	0	0	0	0
13.	Parat e gatshme në bank dhe në arkë	942,989	589,027	848,352	657,847

14.	Stoqet	465,373	535,475	540,516	540,516
15.	Llogarit e arketueshme Euro	10,780,673	10,926,268	10,278,340	9,648,197
16.	Llogarit e pagueshme	5,876,723	8,117,330	3,281,628	5,286,751
17.	Numri I punetoreve	255	270	265	266
18.	Numri I ankesave	452	665	600	600
20.	Numri total I testeve të realizuara	5,906	2,698	1,335	1,334
21.	Matja e treguesve në %				
22.	Uji I pa faturuar	47%	47%	46%	46%
23.	Përqindja e faturimit	100%	100%	100%	100%
24.	Përqindja e konsumit të matur	93%	93%	93%	93%
25.	Proporcioni I kons. Me ujmat	98%	98%	97%	98%
26.	Efikasiteti I stafit	7.95	7.52	7.20	7.17
27.	Shkalla e inkasimit në % (të tërë)	95%	87%	89%	86%
28.	Shkalla e inkasimit në % - amvisni	93%	88%	80%	81%
29.	Shkalla e inkasimit në % - biznese	91%	83%	85%	87%
30.	Shkalla e inkasimit në % - industri	118%	83%	98%	99%
31.	Norma e mbuleses së punes	1.31	1.26	1.25	1.17
32.	Norma e punes	1.38	1.45	1.41	1.36
33.	Shpenzimet Operative per konsumator	6.87	6.60	6.51	6.87

Nr i Konsumatorëve janë parashikuar të rriten për duke u nisur nga rritjet e viteve të Kaluara.

Uji i faturuar për konsumatorët me ujëmatës planifikohet të jetë 93 % e ujit total të faturuar.

Faturimi në € - për vitin 2018 planifikohet të jetë 4,099,951 € në vlerë totale. Faturimi në krahasim me vitin 2017 planifikohet të rritet për +65,279 € ku pjesa më e madhe i faturon Amvisërisë si kategori më e madhe e konsumatorëve pastaj Biznesi i Madh dhe i Vogël dhe Institucionet. Në vitin 2019 planifikohet të jetë +4,222,950 €, në vitin 2020 planifikohet të jetë 4,394,638 Euro.

Arkëtimi i tërë dhe për kategori të konsumatorëve në Euro ,% , m3 - Prioritet i lartë dhe objektiv i parë strategjik i Kompanisë do të jetë rritja e Shkalles së Arkëtimit. Në vitin 2018 shkalla e Arkëtimit në vlerë totale do të jetë 3,525,958 € , 86 % e vlerës së faturuar. Shkalla e Arkëtimit për Amvisëri planifikohet të jetë 81 %, për Biznese Shkalla e Arkëtimit planifikohet të jetë 87%, kurse për institucione 99 %. Në vitin 2019 Arkëtimi planifikohet të jetë 3,673,966 € , 87 % e vlerës së faturuar , në vitin 2020 3,827,682 €, 88 % e vlerës së faturuar. Nga Fondi i privatizimit të Ndërmarrjeve publike. Shuma e borxhit që i takon Ndërmarrjes tonë është rreth 700.000 €, shumë e cila do të na ndihmonte shumë në realizimin e planeve investive. Presione kemi bërë vazhdimisht që këto mjete tona të realizohen pranë AKP-se.

Shpenzimet e përgjithshme operative dhe të mirëmbajtjes në vitin 2018 ,2019 dhe 2020 do të orientohen në funksionimin normal të Kompanisë dhe të gjitha njësive për qëllim të arritjes së synimeve dhe objektivave të përcaktuara si prioritete. Këto shpenzime si të tilla mundësojnë përmbushjen e obligimeve dhe zhvillimin normal të Kompanisë. Në vitin 2018 shpenzimet operative planifikohen të jenë 3,058,366 €, për +223,466 € më të mëdha se vitit 2017. Në vitet 2019 Shpenzimet Operative planifikohen të jenë në vlerë të prej 3,150,117 €, në vitin 2020 planifikohen të jenë 3,224,620 €.

Parashikimi i kërkesës për ujë Parashikimet e kërkesave për ujë për vitete planifikuara do të jetë i bazuar në rritje në numrit të konsumatorëve ,në zvogëlimin e humbjeve si dhe në zgjerimin e rrjetave sipas planifikimit afatmesëm për investimet e projekteve kapitale. Parashikimet mujore të prodhimit do të bazohen në prodhimin e vitit 2017.

Investimet kapitale nga Grandet Qeveritare dhe mjetet e KRU-së

Në bazë të projekteve të mëhershme dhe të projekteve aktuale ideore, si të domosdoshme për përmbushjen e nevojave, blerjen e pajisjeve/mekanismave dhe ndërtimin e objekteve të nevojshme ndërtimore, në vazhdim po i paraqesim projektet domosdoshme të cilat nevojiten për realizimin e planit afatmesëm të investimeve, dhe të cilat njëherit nga pamundësia financiare ne presim që ndonjëra të mund të financohet nga jashtë ose në formë donacioni:

Investimet kapitale për përmirësime infrastrukturore dhe jo infrastrukturore - 2016:		
1.	Investimet jo infrastrukturore	2,997,511
2.	Investimet infrastrukturore	574,138
	TOTALI	3,571,649

Objektivat kryesore

Plani I Biznesit përfshinë synimet afariste të Kompanisë gjatë periudhës 2018-2020 dhe përveç tjerash vlerësohet se do të përmirësoj kontrollin menaxherial mbi Kompaninë dhe shmangien ndaj gabimeve që mund të sjellin atë në dështim të përmbushjes së standardeve të shërbimeve .Plani I Biznesit do ti nënshtrohet rishikimit dhe freskimit në baza vjetore.

KRU"Gjakova" SH.A furnizon me ujë të pijes 35,555 konsumatorë. Synohet që gjër në mbarim të vitit 2018 KRU-ja të zgjeron zonën e shërbimit dhe të rris numrin e konsumatorëve.

Gjatë kësaj periudhe KRU"Gjakova" do vazhdoj të furnizoi konsumatorët e vet me ujë 24 orë .

Krahas përmirësimit të shërbimeve të ofruara Kompania synon që gjatë kësaj periudhe të përmirësoi afarizmin ekonomik dhe atë : Duke shtuar përpjekjet në ngritjen e shkallës së arkëtimit në 86 % në vitin 2018 . Të shtoi masat e kontrollit të ujit të prodhuar i cili i'u shpërndahet konsumatorëve dhe me këtë të ndikoi në zvogëlimin e humbjeve teknike dhe komerciale të ujit ,gjegjësisht të ujit që nuk faturohet dhe Kompanisë nuk i sjellë të ardhura .Uji i pa faturuar në 2018 pritet të ulet në 46 %

Realizimi I këtyre të synimeve do ti mundëson Kompanisë gjenerimin e të ardhurave të mjaftueshme për të qenë vetë financues I qëndrueshëm dhe do ti rrisë aftësitë financiare të Kompanisë për mbulimin e pjesërishëm të investimeve të parapara në periudhën planifikuese.

Kontrolli dhe evitimi I humbjeve teknike dhe komerciale si dhe me mbikqyerjen e shpenzimeve të përgjithshme të Kompanisë ,planifikohet një zvogëlim I shpenzimeve operative .

Krahas ngritjes së kapaciteteve teknike të Kompanisë ,rëndësi e veçante do ti kushtohet ngritjes së aftësive profesionale të stafit ,dhe për këtë menaxhmenti do identifikoi lëmit adekuate për trajnim të stafit .

Për realizimin e qëllimeve kryesore strategjike ,deri në vitin 2020 Kompania ka paraparë përmbushjen e objektivave strategjike si vijon:

- 3 **Zvogëlimi i humbjeve të ujit në rrjetë ;** Këto aktivitete do të përfshijnë identifikimin e humbjeve teknike dhe administrative të sasisë së ujit të prodhuar, gjegjësisht të ujit i cili nuk faturohet dhe nuk i sjell Kompanisë të ardhura. Uji i pa faturuar pritet të ulet në 44% deri në 2020.
- 4 **Zgjerimi i sistemit të rrjetave të reja në vendbanime;** janë pjesë e planit të biznesit e të cilat planifikohen që të realizohen me mjete vetanake të Ndërmarrjes si dhe me mjete nga donacionet nga Qeveria e Kosovës .

- 5 **Ndërrimi i rrjetit të ujësjellësit** – profil të cilëve kaqe në i pamjaftueshëm për nevojat e konsumatorëve, të cilat janë punarngamaterialejoadekuatesenëatogypajanëdefektetëpërsëritshme;
- 6 **Përmirësimi i funksionimit të sistemit;** Ngritja e nivelit të sigurisë punuese të sistemit të furnizimit me ujë, domosdoshmëria epajisjeve te lemetrike,mjetet e reja pune etj
- 7 **Përmirësimi i matjeve të ujit në sistem dhe te konsumatorët.**

7.7.2 Përmbledhje e arsytiveve për ndryshime te mundshme ne planin e biznesit nga viti paraprak .Çka duhet të jetë më ndryshe se Plani i Biznesit 2017

Ndryshimet e parashikuara nga Plani i Biznesit nga viti paraprak, arsyet për këto ndryshime i prezantojmë për secilin tregues kryesor si më poshtë;

Faturimi në euro-në krahasim me vitin 2017 planifikohet të rritet për +82,332 €.Konsiderojmë se do arrihet rritja e këtij treguesi i cili është baza e zvogëlimit të humbjeve të ujit ,eliminimin e lidhjeve ilegale,paushallit si dhe rritjes së numrit të konsumatorëve .Këtë tregues Kompania do ta arrij ta realizoi sipas BP të planifikuar përmes stafit të organizuar të shitjes, grupeve të caktuara sipas 5 zonave , si dhe ndihmesës së institucioneve lokale të Komunave dhe autoriteteve Qendrore .

Uji i faturuar për konsumatorët me ujëmatës planifikohet të jetë 98% e ujit total të faturuar. Kompania përmes angazhimit të stafit të operatives do të arrij qe të bej vendosjen e ujëmatësve për konsumatorët e të gjithë kategorive .Këtë ndryshim të mundshëm nga BP i vitit paraprak kompania e mbështet në arsyetimin se është një ndër objektivat dhe synimet kryesore që të eliminohen faturimi i konsumatorëve përmes paushallit ,sepse është e njohur se me këtë veprim zvogëlohen humbjet e ujit tek Kompania ndërsa te konsumatori bëhet një vlerësim real i shpenzimit të shërbimit të ujit.

Arkëtimi i tërë në Euro, % dhe m3 – Bazuar në BP që në vitin 2018 Arkëtimi në vlerë totale do te jete 3,525,958 € , 86 % e vlerës së faturuar. Bazohet në arsyetimin se Kompania si Ndërmarrje vetë financuese ku të ardhurat i siguron vetëm nga arkëtimi do të gjej metodat ,programet më të avancuara që maksimalisht të arrij shkallen më të lartë të mundshme të inkasimit përmes : Organizimit të Grupeve të Kontrolles dhe Çkyçjes ,përcaktimin e grupeve sipas 5 zonave , rritjen e numrit të pikave të shitjes në tërë regjionin që operon Kompania , zonave për arkëtim dhe humbje të ujit, eliminimit të keqpërdorimit të ujit , riprogramimet e borxheve me te gjitha kategoritë e konsumatorëve ,eliminimit të humbjeve teknike ,bashkëpunimit me palët e treta ,Policinë ,Inspektorët Komunal si dhe autoritet gjyqësore.

Shpenzimet Operative – Shpenzimet operative për vitin 2018 sipas BP do të jenë 3,058,366 euro për 223,466 € më të mëdha se planifikimi i vitit 2017. Shkaku i këtij ndryshimi në planifikimin e BP është se Kompania po përballlet me dukurit ; bashkëfinancimi nga buxheti i Kompanisë ne realizimin e Projekteve të mëdha,ndërtimi me mjete vetanake të infrastruktures ujore , infrastrukturës rrugore , ndërtimi dhe renovimi i infrastrukturës së objekteve të kompanisë, Rritjen e inflacionit, rritjes së vazhdueshme të çmimit të energjisë elektrike, kemikaleve, karburanteve te naftës, mirëmbajtja e pajisjeve dhe rrjetës. Pjesën më të madhe të shpenzimeve e përfshijnë shpenzimet e personelit (përfshin pagat, mëditjet, bonuset, trajnimet), shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimeve (përfshin pjesët e vogla për riparim, mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, mirëmbajtja e automjeteve etj),

shpenzimet e energjisë elektrike, shpenzimet e derivateve (përfshin naftën dhe benzinës për Kompaninë), shpenzimet e kemikaleve (përfshin alumin sulfatin, klor i gazet, klor i lënget, kloruri i hekurit dhe karboni aktiv), si dhe shpenzimet tjera (përfshin shpenzimet administrative, regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve,taksat për licencim të shërbimeve ARRU, taksa e ShUKOS-it, taksa për shfrytëzimin e ujit MMPH, shërbimet nga palët e treta).

Gjatë vitit 2017 Kompania parasheh tipuaj të gjitha shpenzimet operative për zhvillimin e veprimtarisë normale.

Nr i Konsumatorëve- për vitin 2018 janë parashikuar të rriten 1,553 konsumatorë duke u bazuar nga rritjet e viteve të Kaluara. Kompania do të bëjë evidentimin në sistem të konsumatorëve të cilët furnizohen në mënyrë të pa legalizuar ,do ekzekutoj dënime administrative si dhe gjoha për konsumatorët e pa ndërgjegjshëm që keqpërdorin ujin etj.

Prodhimi I ujit të pijes - Prodhimi i ujit për vitin 2018 është planifikuar të jetë 15,494,902 m3, për 377,432 m3 më shumë se BP i vitit 2017 si pasojë e rritjes së lehtë të konsumatorëve.

Programet e testimit të ujit të pijshëm- Përmirësimi i cilësisë së ujit të pijshëm,në laboratorët tona,si në atë për analizat fiziko- kimike dhe atë bakteriologjike, të përdorim disa programe të testimit të cilësisë së ujit,si p.sh.:Programi i analizës volumetrike pH-metrisë, konduktometrisë, fotometrisë etj.

Ristrukturimi organizativ – Radhitja e personelit për mes departamenteve në favor të produktivitetit të përgjithshëm, duke ngritur ato në vazhdimësi për mes përgatitjes dhe të përshtatjes profesionale; Pozicionimin dhe vërtetimin e pozitave të pasistematizuara deri më tani dhe, sipas nevojës për pozitë e punëve të domosdoshme; Të bëhet planifikimi i mundësisë së kualifikimit të vazhdueshëm të personelit përmes shkollimit.

Zbatimi i kompjuterizimit të gjerë të kompanisë; Blerja e kompjuterëve në mënyrë të njëtrajtshme ,ku me këtë do të ruhej uniformiteti performancës së tërë sistemit dhe do të ulëshin shpenzimet e mirëmbajtjes ,implementimi i Intranetit të kompanisë i cili do të rrit efikasitetin e administratës,do të zvogëlonte shpenzimet administrative si dhe do të mundte kontrollohej performanca e shërbyesve administrativ të kompanisë duke përcjellë azhurnitetin në administratë.

Sistemet të reja të menaxhimit të informacionit dhe të raporteve-Monitorimi i dhënie-marrjes së informatave mbi performancën e sistemit dhe verifikimin e furnizimit të konsumatorëve me ujë cilësor. Këto përfshijnë testimin e monitorimit analitik dhe vëzhgimor sikurse që janë inspektimet si dhe testimin Mbi Kënaqësinë e konsumatorit .

Programe të zhvillimit të burimeve njerëzore

Trajnimi i Resurseve që aktiviteti i tyre në kompanitë bëhet komfor konkurrencës së tregut, e që do të shërbejë veprimtarisë kryesore të punëve tona shërbyese, për kualitetin dhe distribuimin e ujit të pijes dhe që me këtë të arrihet përmbushja e kërkesave dhe nevojave ndaj konsumatorëve tanë;

Marrëdhëniet ndërmjet konsumatorit dhe Kompanisë sonë –Obligimin dhe angazhimi në mirëmbajtjes sipas standardeve minimale të shërbimit; Nevoja për vlerësime dhe reagime të përgjegjshme ndaj nevojave të konsumatorëve Përgjegjësi dhe në përputhje me rregullat në fuqi; Përdorimet i ligjeve aktuale në fuqi dhe kompetencave në furnizim me shërbime; dhe obligimet në përkrashjet e arritjeve tekniko-teknologjike në aplikimin e praktikave të kohës

Informimi i konsumatorëve-Planifikimi afatgjatë i programeve komunikuese sistematike. Kjo do të

siguronte të gjithë ata konsumatorë të cilët kanë qasje në informacione nga keqinterpretuesit e zëshëm.

3.8. RREZIQET E TË ARDHMES SË KORPORATES

3.8.1 Rreziqet kryesore qe ndërmarrja do te ballafaqohet gjatë dy viteve të ardhshme

Meqë ndikimet që vijnë nga jashtë ,respektivisht nga rrethina afariste ,janë implikimet e tij në veprimtarinë e Kompanisë, janë analizuar dhe identifikuar disa nga rreziqet e mundshme që janë dhënë në vazhdim;

- Vendimi i Qeverisë ne fshirjen e borxheve per persona fizik dhe juridik jo publik .
- Moslejimi i ngritjes së tarifave në përputhje me shpenzimet nga Rregullatori
- Rritja e tarifave të shpenzimit të rrymës
- Heqja e pagesave kesh tek inkasantet
- Rritja e nivelit te furnizimit të rajoneve me pompa
- Ndryshimet e mundshme klimatike siç është ngrohja globale që po ndikon në masë të madhe në zvogëlimin e resurseve ujore në përgjithësi .
- Rritja e keqpërdorimeve të konsumit të ujit të pijes
- Avarit në pajisjet dhe stabilimentet e rëndësisë së lartë dhe dëmtimet mekanike,Ndërprerjet etej zgjatura të furnizimit me shërbime s pasojë e fuqisë mbi natyrore;
- Ndikimet ekstreme të motit dhe katastrofave natyrore (erërat,zjarri,vërshimet,tërmetet,
- Vandalizmat dhe sabotimet;
- Si dhe Ndikimi i ndotjeve të papritura (hedhjet e kimikaleve mbi dhe në kaptazhë ose nëresurset ujore,neglizhenca në proceset e përpunimit të ujit,etj.)

Komentoni ne secilin rrezik qe mund te paraqitet gjatë operimit te ndërmarrjes .

- Kërcënimet financiare, paraqesin rrezik të veçantë dhe reflektojnë në shkaktimin e vështirësive të të hyrave të pamjaftueshme të cilat pamundësojnë investimet kapitale .
- Një rrezik që duhet pasur parasysh me të cilën po ballafaqohet një pjesë e madhe e botës është edhe kriza globale , që ndikojnë në kapacitet financiar të partnereve afarist si dhe përkeqësimin e gjendjes ekonomike të konsumatorëve që reflekton në zvogëlimin e mundësisë së tyre për pagesën e faturave të shërbimeve per shkaqe të gjendjes së tyre ekonomike .
- Moslejimi i ngritjes së tarifave në përputhje me shpenzimet për zhvillimin e veprimtarisë së Kompanisë është faktor ndikues gjegjësisht që paraqet rrezik potencial për të hyrat e kompanisë.
- Kërcënim të veçante paraqesin edhe ndryshimet e mundshme klimatike siç është ngrohja globale që po ndikon në masë të madhe në zvogëlimin e resurseve ujore në përgjithësi .
- Rritja e keqpërdorimeve të konsumit të ujit të pijes si pasoj e mos funksionimit në masë të duhur të organeve të rendit dhe Gjykatave
- Avarit në pajisjet dhe stabilimentet e rëndësisë së lartë dhe dëmtimet mekanike, Ndërprerjet etej zgjatur atë furnizimit me shërbime si pasojë e fuqisë mbinatyrore

- Ndikimi i ndotjeve të papritura(hedhjet e kimikaleve mbi dhe në kaptash ose në resurset ujore,neglizhenca në proceset e përpunimit të ujit,etj.)
- Ndikimet ekstreme të motit dhe katastrofave natyrore (erërat,zjarri,vërshimet, tërmetet,Vandalizmat dhe sabotimet;
- Rritja e kostonë së jetesës së konsumatorëve ,si shkak i rritjes së çmimeve –inflacionit ,për këtë do të kemi vështirësi në arkëtimin e borxheve të konsumatorëve të cilëve do ju rriten shpenzimet jetësore , e që do të ndikoi në pa mundësin e tyre në kryerjen e detyrimeve të ndaj Kompanisë për shërbimet e pranuar .
- Fshirja e borxheve nga Qeveria deri ne 2008 .Implementimi i këtij Vendimi ka sjell humbje financiare Kompanisë ,si dhe rënje te treguesve financiar .

3.9.1 Çfarë duhet të behet për të ulur ndikimin e secilit rrezik.

Që të ulim ndikimin e secilit rrezik që na përcillet ne veprimtarinë tonë , kërkohet që të ndërmerren veprimet ;

Vazhdimi i aktivitetit rreth evitimit të pengesave gjatë zhvillimit të aktiviteteve në Kompani ;

Thellimin i dijeve përbrenda kompanisë mbi procedurat e veprimeve operative; Ngritje në cilësi të shërbimeve tona, dhe përmirësimin e kushteve të punës dhe standardin e punëtorëve tanë. Nevojën e implementimit të Programit për zvogëlimin e humbjeve dhe keqpërdorimeve të ujit, si njëra nga projektet zhvillimore për ndonjë donacion i mundshëm; Nevojat për rregulloret në pajtueshmëri të plotë me kërkesat legislative. Vlerësimin e aktiviteteve afariste për KRU "Gjakova "-in (për tre muajt në vazhdim) i planifikojmë në drejtim të lëvizjeve më pozitive, të rishikohen rregullisht për arritjet e praktikave më të mira të përvetësuara; Mënyrat më të mundshme të marrëveshjeve për furnizimin; Diskutimet paraprake mbi vendimet për zgjerimin e shërbimeve; Bashkëpunimi intensiv me palët e interesit; Pajtueshmërinë e plotë ndaj kërkesave legislative dhe rregullatorit Intervenime në defektet që kanë të bëjnë me shërbimet ndaj konsumatorëve;

Marrja e masave operative dhe juridike për eliminimin e rreziqeve të arkëtimin të të hyrave –

Kosto ekonomike të furnizimit dhe shërbimeve; Caktimi i tarifave mbi shërbimet dhe mbi pagesat tjera, faturimi i obligimeve të konsumatorit për pagesën e shërbimeve , informimi i konsumatorëve,shqyrtimi i ankesave ndaj shërbimeve; Diskutimet paraprake mbi vendimet për zgjerimin e shërbimeve ,nevojat për rregulloret në pajtueshmëri të plotë me kërkesat legislative,rritjen e të hyrave dhe zvogëlimin e shpenzimeve, zvogëlimin e humbjeve të ujit në rrjetë, investime të nevojshme e të rikthyeshme (të shpagueshme) ,zvogëlimin e prodhimit të ujit pa dëmtuar konsumatorin , arritjen e objektivave operative me një çmim kushtues sa më të vogël, furnizim për mirëmbajtje me një çmim sa më të arsyeshëm, me ujëmatës,mbështetja në funksion të sektorit të shërbimeve për intervenime në defekte, faturimi i obligimeve të konsumatorit për pagesën e shërbimeve ,zvogëlimin e humbjeve të ujit në rrjetë, si dhe të mjeteve të punës , rritjen e sasisë së ujit të shitur, të faturuar ;

Avancimi I operimit të rrjetit të ujit dhe të kanalizimit-Realizimi I projekteve përmes thithjes së donacioneve apo me mjete të Kompanisë për rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit si dhe rrjetat e reja të kyçjes së Konsumatorëve të rij të një komuniteti ,nevojën për prodhim të ujit sa më cilësorë sipas kapaciteteve të instaluar,pajtueshmëri të plotë të resurseve në proceset e prodhimit me qëllim të shfrytëzimit sa më racional të ujit ,ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave të zeza etj.

Implementimi ofiçient i investimeve kapitale të KRU-ve-Angazhimi maksimal I Sektorit për Planifikim dhe Zhvillim në hartimin e projekteve të planifikuara si dhe implementimi ofiçient i investimeve kapitale me theks të veçante nga mjetet donacionet e Qeverisë ,angazhimi maksimal i Zyrës së Prokurimit në realizimin me kohë të procedurave për realizimin e tenderëve që me kohën optimal të arrihen të realizohen mjetet nga ekzekutimi I kontratave me operatorët ekonomik qe mjetet të dhuruara nga Qeveria e Kosovës të mos kthehen në Buxhetin e Kosovës

Seanca takimesh dhe mbledhjesh më të shpeshta të KRU "Gjakova"-it, Raportimet e rregullta për realizimin e Planeve dhe Programeve për masat dhe veprimet që duhet të merren nga çdo Menaxher në veprimtarinë e Depratamentit që i përket për uljen e rreziqeve të mundshme që paraqiten gjatë ushtrimit të veprimtarisë në sferën e ; përmirësimit dhe ngritjes së nivelit në përmbushjen e obligimeve ndaj konsumatorëve, informimi i konsumatorëve,shqyrtimi i ankesave ndaj shërbimeve ,prodhimit ,inkasimit,humbjeve të ujit ,mirëmbajtjes së objekteve ,intervenimet emergjente në sanimin sa më të shpejt të avarive ,te shqyrtohen planet e intervenimeve emergjente në rastet e mundshme të fatkeqësive natyrore ,shkatrimit të objekteve.

Përgjigje më kreative në rastet e reagimeve emergjente-Të përpilohen Planet dhe programet në çdo fushë të veprimtarisë për intervenime emergjente komfor legjislacionit në fuqi në Kosovë si dhe akteve të brendshme në Kompani . Të bëhet informimi i saktë dhe i shpejt i popullatës për çdo reagim emergjent në të gjitha fushat e veprimtarisë , intervenime për Çkryçje si rezultat i veprimeve të natyrave të ndryshme defekte ,avari të mundshme ,diversione ,sabotime ,kushte atmosferike ,çkryçje kolektive etj.

Përmirësimet në menaxhimin e aseteve;

Të përfundohet procedura e legalizimit të gjitha aseteve të Kompanisë në emër të kompanisë si dhe vlerësimi i tyre në kontinuitet me rregullat financiare nga zyrtari i vlerësimit të aseteve , të bëhet inkorporimi në sistem i të gjitha aseteve si dhe arkivimi i dokumentacionit të për asete .

PORTET E AUDITORIT TË BRENDSEHM

Bordi i Drejtorëve gjatë punës së tij ka konstatuar se në kuadër të organizimit të përgjithshëm të kompanisë është jashtëzakonisht e rëndësishme mes të tjerave të punohet në konstatimin e menaxhimit të rrezikut, përmes punës së Auditorëve të Brendshëm, sa ata kanë arritur të bëjnë identifikimin e rrezikut në raportet e tyre dhe të japin rekomandimet e tyre në eliminimin e parregullsive që tregojnë rrezik për kompaninë. Bordi i Drejtorëve përmes Komisionit të Auditimit ka arritur të siguroj efikasitetin e kontrollit të brendshëm përmes programit të punës për Auditimin e Brendshëm sipas ecurisë:

Faza e procesit	Procesi - Hapat
Plani	Krijimi i kontestit Vlerësimi i rrezikut Plani i rrezikut – Trajtimi Plani i rrezikut të mbetur
Kontrolla	Monitorimi i vazhdueshëm dhe Inspektimi
Aktiviteti	Ruajtja dhe përmirësimi i Procesit të menaxhimit të rrezikut

Konform kësaj ecurie, dhe Planit Vjetor mbi ushtrimin e kontrollës së brendshme në kompani të përpiluar nga KA për Auditorin e Brendshëm, është arritur të realizohet 100% të këtij Plani, të konstatohet shkalla e rrezikshmërisë, si dhe të ipen rekomandimet në lidhje me eliminimin e të njëjtave përmes raporteve si më poshtë:

- Raporti i Menaxhimit të Mjeteve Themelore dhe Stoqueve
- Raporti i Auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare
- Raporti i Sigurisë në Punë të Punëtorëve dhe Objekteve
- Raporti përmbledhës mbi implementimin e rekomandimeve Tetor 2016 - Prill 2017
- Raporti i Menaxhimit të Shpenzimeve Operative
- Raporti i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
- Raporti i Procesit të Menaxhimit të të Hyrave
- Raporti i Sistemit për Menaxhimin e Procedurave të Prokurimit
- Raporti përmbledhës mbi implementimin e rekomandimeve Maj 2017 - Tetor 2017
- Raporti Vjetor i ZAB për Vitin 2017

Përmes Auditorit të Brendshëm ka ardhur deri në një masë të konsiderueshme gjetja e rreziqeve kryesore në biznesin e Ndërmarrjes. Auditimi i Brendshëm bazuar në punën e pavarur, është i obliguar të japë një pasqyrë reale të situatës ekzistuese dhe shërbimeve këshilluese të dizajnuara ashtu që të shtojë vlerat dhe të përmirësojë veprimtarinë e kompanisë. Ndihmon kompaninë që të përmbush objektivat e saj duke sjellur një qasje sistematike disiplinore për përmirësimin e efekteve të menaxhimit, zvogëlimin e rrezikut në proceset legjislative.

Me planifikimin e procesit të Auditimit për vitin 2017 janë audituar rregullat dhe procedurat në bazë të standardeve dhe Ligjit të Ndërmarrjeve Publike, i cili ka përfshirë testet dhe procedurat e nevojshme për të shprehur konkluzionet dhe rekomandimet .

ANEKSI 1.

1. SPONZORIMET DHE DONACIONET

Investimet kapitale gjatë vitit 2017 janë realizuar nga Grandi Qeveritar nga CDI (Inisiativa e Zhvillimit të Komuniteteve) ,Komunave si dhe nga mjetet vetanake te Kompanisë .Këto investime kanë qenë të planifikuara me Biznes Planin e vitit 2017 .

Me investimet nga Donacionet është bërë realizimi i projekteve

Investimet nga donacionet e Qeverisë,Bashkimi Evropian ,CDI ,Komuna për vitin 2017

- Projekti LOTI 2 "Linja e unit te pijes nga baseni i Radoniqit, linja e Anadrinit , linjat dhe infrastruktura mbështetëse, Faza e dytë. **Totali i donacionit - Për 2017: 901,134.63 €.**
- Projekti LOTI 3 Kanali Derivues i Bazenit të Radonqit ,Linja dhe Infrastruktura Mbështetëse është financuar nga MZHE në Totalin e Donacionit -Për 2017 :**500,311.23 €.**
- Rehabilitimi i sistemeve rurale të ujësjellësit në zonën e shërbimit të KRU " Gjakovë " Sh.A Gjakovë, për të gjitha fshatrat te investuara nga CDI. Totalin e Donacionit -Për 2017 Lot 1. dhe Lot 2 **Vlera 1,081,206.85 €.**

Tabelari – Projektet e realizuara nga Donacioni nga Qeveria e Kosovës ,CDI ,Komuna për vitin 2017

Emri i Projektit	Vlera Euro	Operatori Ekonomik i kontraktuar
Lot 2: Linja e ujit te pijes nga baseni i Radoniqit, linja e Anadrinit , linjat dhe infrastruktura mbështetëse, Faza e dytë.	Donacioni nga MZHE Totali i donacionit – Për 2017 901,134.63 €	"PEVLAKU" shpk Kontrata te ralizohet per 3 vite të realizohet në vlerë:2,770,512.96 €
Lot 3 : Kanali derivues I basenit te Radoniqit, linja dhe infrastruktura mbështetëse	Donacioni nga MZHE Totali i donacionit - Për 2017 500,311.23 €	"PEVLAKU" shpk Kontrata të Realizohet 3 vite në vlerë: 1,739,519.68 + 173950.88= 1,913,470.56 €
Rehabilitimi i sistemeve rurale të ujësjellësit në zonën e shërbimit të KRU " Gjakovë " Sh.A Gjakovë, për të gjitha fshatrat te investuara nga CDI Lot 1. dhe Lot 2	Donacioni nga DORCH/CDI Totali i donacionit i realizuar - Për 2017 1,081,206.85 € Mbetet për me u realizuar për 2018 360,402.28 €	KWE Kontrata bazë në vlerë: Lot 1 537.456,59 € Puna + Materiali 155,232.00 € Gypat 523,265.00 € Totali lot 1 1,216,039.50 € <u>Totali lot 2 235,569.63 €</u> 1,441,609.13 €
TOTALI	2,482,652.71	

1. RAPORTIMET SIPAS LIGJIT MBI NDERMARRJET PUBLIKE

a.) STRUKTUARA ORGANIZATIVE AKTUALE E KRU"RADONIQI"SH.A.-GJAKOVË,DUKE PËRFSHIR TË GJITHA NDRYSHIMET E KONSIDERUESHME QË JANË BËRË GJATË VITIT PËRKATËS

Makro struktura e aprovuar me këto ndryshime ka ardhur si rezultat i kërkesave ligjore nga ligji mbi Ndërmarrjet Publike ,Ligji I Punesë , Ligji I Prokurimit Publik si dhe ligjet tjera në fuqi në Kosovë .Duke u bazuar në këtë ,ndryshimet do të ndikojnë në ngritjen e efikasitetit dhe performances së kompanisë në përgjithësi por edhe në performancën e individëve të caktuar në arritjen e objektivave të përcaktuara .Struktura organizative K.R.U."Gjakova" Sh.A.-Gjakovë e përbërë nga;

Bordi i Drejtorëve

Organ më i lartë për shkak të dorëheqjes së dy drejtorëve jo ekzekutiv përbëhet prej 6 drejtorë jo ekzekutiv dhe një drejtori ekzekutiv , si dhe Sekretarin e Bordit të Drejtorëve i cili ka pozitën e vëzhguesit pa të drejtë vendimmarrje.

Struktura Menaxhuese brenda në kompani

Afarizmi i Kompanisë zhvillohet nga 3 Departamente .Në strukturën Organizative janë përfshirë edhe pozita e KE ,Zëvendës i KE Sekretari i Kompanisë ,Zyrtarit Kryesor Financiar si dhe zyrtarit për Auditim te brendshëm. Organizimi K.R.U. "Gjakova" Sh.A.-Gjakovë është i bazuar në afarizmin tekniko –operativ ku mbulohet me Departamentin Teknik Operativ. Afarizmi tjetër ka karakter ;Projektues ,komercial,ligjor ,mardh me Kons. Personelit . Në përgjithësi veprimtaria e Kompanisë mbulohet nga ; Departamenti Financiar ,Departamenti I Administratës së përgjithshme dhe Departamenti I Operatives Teknike .

b.) SHQYRTIMI I PERFORMANCES AFARISTE FINANCIARE GJATË MUAJVE JANAR – DHJETORË 2017

Në vazhdim po paraqesim Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për periudhën Janar- Dhjetor 2017 të përgatitura në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiarë.

Pasqyra e të ardhurave

Ky raport financiarë është krijuar në atë mënyrë ku nga te hyrat e faturuara janë zbritur të gjitha shpenzimet operative duke e përfshirë edhe shpenzimet jo operative siç janë shpenzimet e zhvlerësimit.

Nëse krahasohen zërat në pasqyrën e të ardhurave për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2017 me atë të vitit 2016, shihet se te hyrat e faturuara totale kanë një rritje prej 110,252 €, si shkak i rritjes së faturimit dhe zvogëlimit të humbjeve, kurse shpenzimet operative kanë një rritje prej 87,826 €, si pasojë e rritjes së aktivitetit të Kompanisë dhe inflacionit. Shpenzimet e zhvlerësimit kanë zvogëlim prej 360,881 si pasojë e ndrrimit të politikave kontabël €. Këtë vit Kompania ka llogaritur shpenzim të borxhit të keq në vlerë prej 47,593 €.

Para se të llogariten shpenzimet e zhvlerësimit Kompania-Pasqyra e të Ardhurave operon me fitim prej 1,376,903€, mirëpoedhe pasi llogariten shpenzimet e zhvlerësimit dhe borxhi i keq Kompania operon me fitimë financiar prej 13,498€.

Të hyrat njihen kur është mundësia e përfitimeve ekonomike lidhur me rrjedhën e transaksioneve të ndërmarrjes dhe kur shuma e të hyrave mund të matet besueshëm. Te hyrat njihen sipas parimit akrual, në momentin e fitimit.

Shpenzimet operative njihen në pasqyrën e të ardhurave në kryerjen e shërbimit ose në datën e origjinës. Shpenzimet njihen sipas parimit akrual, në momentin e ndodhjes.

Bilanci i Gjendjes

Baza e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitura në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiare . Pasqyrat Financiare janë përgatitura sipas parimit të kostos historike, ndërsa e modifikuar për paraqitjen e pronës, impianteve dhe pajisjeve në shumat e rivlerësuar. Këto pasqyra janë përgatitura nën pohimin se Kompania do të vazhdojë vijueshmërinë e sajë së paku edhe për 12 muaj.

Pasqyrat financiare janë të krahasueshme pasi i paraqesim në dy vite 2017 dhe 2016.

Politikat konsistente, ku të njëjtat politika të kontabilitetit përdoren nga viti në vit si p.sh. metoda e zhvlerësimit është e njëjtë nga viti në vite – Metodën Drejtvizore ose Lineare Mirepo tek kemi pasur ndryshim tek politikat kontabël duke e ndryshuar shkallën e zhvlerësimit të objekteve ndërtimore në 2%

Valuta

Këto pasqyra financiare të konsoliduar janë prezantuar në Euro, që është monedha funksionale në Shtetin tonë.

Prona, impiantet dhe pajisjet

Prona, impiantet dhe pajisjet janë bartur sipas rivlerësimit të bërë nga Kompania Grant Thornton si vlerësues të pavarur, blerjet dhe duke e zbritur zhvlerësimi i akumuluar pasues. Efekti i rivlerësimit është vendosur në llogarinë e kapitalit-rezervat e rivlerësimit. E gjitha pozicionet e pronës, impianteve dhe pajisjeve janë paraqitura sipas kostos zbriture për zhvlerësimin e akumuluar. Kosto paraqet shpenzimet që i atribuohen direkt përvetësimit të zërave.

Toka nuk është e zhvlerësueshme . Zhvlerësimi në pajisjet tjera është bërë me metodën drejtvizore për të alokuar kostot e tyre siç vijon:

Ndërtesat me	2%
Pajisjet dhe makineria me	10%
Kompjuterët dhe pajisjet për zyre	20%

Llogarit e Arkëtueshme dhe kërkesat tjera

Llogarit e arkëtueshme në fillim njihen me vlerën e tyre reale dhe paraprkisht të matura me koston e amortizimit , minuse provizionimit për dëme.

Vlera bartëse e llogarive të arkëtueshme zvogëlohet përmes një kontoje për lejim, shuma e humbjes njihet ne pasqyrën e të ardhurave, kurse vlera e llogarive të arkëtueshmeve ne bilancin e gjendjes paraqitet neto, duke ja zbritur totalit provizionimet.

Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë paranë në bankë dhe në dorë.

Stoqet

Vlera e stoqeve paraqitet me koston me të ulët apo me vlerën neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është çmimi shitës zvogëluar për koston e kompletimit, marketingut dhe shpërndarjes. Kosto parimisht është përcaktuar në bazë të çmimit mesatar.

Kapitali Aksionar

Kapitali aksionar është përcaktuar duke përdorur vlerën nominale të aksioneve që janë lëshuar. Rezervat- Rezervat paraqesin ndryshimet ndërmjet kapitalit aksionar të regjistruar dhe vlerës neto të Aseteve siç është përcaktuar nga vlerësimi i pavarur në datën e inkorporimit të Kompanisë.

Llogarit e paguara dhe detyrimet tjera

Të pagueshmet tregtare dhe te tjera njihen në vlerën reale dhe më pas maten me koston e amortizimit duke përdorur metodën efektive të interesit. Kryesisht janë borxhet qe kompania i ka ndaj furnitorëve , TVSH-se dhe të Hyrat e shtyera .

Beneficionet e punëtorëve

Kompania kontribuon për punëtorët e saj në planet e pensionimit si janë të përshkruara nga legjislacioni i sigurimit shoqëror miratuara nga Shteti. Kontributet, bazuar në paga, bëhen tek , Trust i Kursimeve Pensionale Kosvës(TKPK). Nuk ka ndonjë detyrim shtesë lidhur me këto plane dhe këto skema konsiderohen si plan i caktuar i kontributeve. Kompania nuk ka beneficione pas pensionimi për punëtorët e tyre.

PASQYRA E TE ARDHURAVE PER VITIN E PERFUNDUAR ME 31.12.2017				
	Shënimet	2016	2017	indeksi
1 Tëhyratngashitjaeujit		3,791,423	4,034,672	+243,249
2 Tëhyrattjera		409,726	276,729	-132,997
2.1Zvogluarpërlirimetnëshitje				
2.2Shitjetekthjera				
2.3Shitjetneto				
2.4Shpenzimetemallraketëshitura				
Fitimibruto		4,201,149	4,312,476	+110,252
3 Shpenzimetoperative				
3.1Shpenzimetepagave		-2,097,724	-2,111,233	+13,509
3.2Shpenzimeteriparimevedhemirëmbajtjes		-69,704	-112,752	+43,048
3.3Shpenzimetadministrativedhetelefonit		-23,741	-30,201	+6,459
3.4Shpenzimeterrymëselektrike		-261,944	-283,694	+21,749

	3.5Shpenzimetederivateve		-62,576	-72,260	+9,683
	3.6Shpenzimetekemikaljeve		-32,912	-28,581	+4,332
	3.7Shpenzimetemarketingut		-10,939	-20,970	+10,031
	3.8Shpenzimetjtjeraoperative		-287,128	-274,807	-12,322
	Totaliishpezimeveoperative		2,846,672	-2,934,498	+87,826
4	Tëardhuratoperuese		84.00	0	-84.00
	4.1Tëardhuratjtjera				
	4.2Eardhurangadividenda				
	4.3Eardhurangainteresi		83.70	0	
	Fitimi para Zhvlerësimit të Aseteve		1,354,561	1,376,903	+22,342
5	Shpenzimetjtjera				
	5.1Shpenzimet e zhvlerësimit		-1,676,692	-1,315,811	-360,881
	5.2Shpenzimet e borxhit të keq		-210,456	-47,593	-162,863
	Fitimi/Humbjaevitit		-532,587	+13,498	+546,085

PASQYRAE BILANCIT TË GJENDJES PER VITIN E PERFUNDUAR ME 31.12.2017

		Shënimet	2016	2017	indeksi
1	Pasuritë				
	1.1 Pasuritëjoqarkulluese				
	1.1.1 Toka ,ndertesa dhe pasurit tjera		29,133,322	31,389,357	+2,256,034
	1.1.2 Pasuritëedhënanëlizing				
	1.1.3 Investimetafatgjate				
	1.1.4 Depozitateafatizuar				
	Totalipasurivejoqarkulluese		29,133,322	31,389,357	+2,256,034
	1.2 Pasuritqarkulluese				
	1.2.1 Stoqetneto		465,373	535,475	+70,102
	1.2.2 Llogaritarkëtueshme		6,691,597	7,154,086	+462,489
	1.2.3 Kërkesattjera		145,507	104,511	-40,996
	1.2.4 Parapagimet				
	1.2.5 Parajadheekuivalenteteparasë		942,989	589,027	-353,962
	Totalipasuriveqarkulluese		8,245,465	8,383,099	+137,637
	Gjithsejtpasuritjoqarkulluesedheqarkulluese		37,378,788	39,772,455	+2,393,668
2	Ekuitetidherezervat				
	2.1 Kapitalliemituar		25,000	25,000	0
	2.2 Rezervatervlerësimit		31,575,845	31,576,051	+206
	2.3 Fitimi/Humbjaekumuluar		0	-2,459	-2,459
	2.4 Fitimi/Humbjaevitit		0	13,498	+13,498
	Totaliiekuitetidherezervave		31,600,845	31,612,090	+11,246
3	Detyrimet				
	3.1 Detyrimetjoqarkulluese				
	3.1.1 Detyrimetafatgjata				
	3.1.2 Granteteshtyera		4,321,410	6,365,232	+2,043,821
	Totaliidetyrimevejoqarkulluese		4,321,410	6,365,232	+2,043,821
	3.2 Detyrimetqarkulluese				

	3.2.1	Llogaritëpagueshmedhetëtjera	262,761	897,748	+634,987
	3.2.2	Tatimetpagueshme	1,136,504	855,912	-280,592
	3.2.3	Shpenzimetakruale	57,268	41,474	-15,794
Totaliidetyrimeveqarkulluese			1,456,533	1,795,134	+338,601
Totaliidetyrimevejoqarkulluesedheqarkulluese			5,777,943	8,160,365	+2,382,422
Gjithsejtekitetidhedetyrimet			37,378,788	39,772,455	+2,393,667

PASQYRA E RRJEDHJES SE ARKES PER VITIN E PERFUNDUAR ME 31.12.2017

		Shënimet	2016	2017	indeksi
1	Rrjedhjaearkësngaaktivitetetoperacionale				
	Fitimi/Humbjaparatatimit		-532,587	13,498	+546,085
	1.1	Parashtruarnga			
	1.1.1	Tëhyratngagrantet			
	1.1.2	Tëhyratfinanciare			
	1.1.3	Zhvlerësimet	1,676,692	1,315,811	-360,880
	1.1.4	Lejimetpërborgjetekëqija	210,456	47,593	-162,863
Fitimioperativparandryshimetnekapitalinpunues			1,354,561	1,376,903	-22,342
	1.2	Ndryshiminëkapitalinpunues			
	1.2.1	Stoqet	-874	-70,102	+69,222
	1.2.2	Llog.earkëtueshmedhearkët.tjera	1,114,677	2,258,485	+1,143,808
	1.2.1	Detyrimettjeratregëtare	222,867	-338,601	-561,467
